بسم الله الرحمن الرحيم

**ME EMRIN E ALL’LLAHUT**
**TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

# DRITA E KUR'ANIT

**REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE**

**TIRANË, 2012**

**DRITA E KUR'ANIT**

Drejtor: prof. Muhammed Reza Haj Khezr

**REDAKSIA:**
Prof. dr. Hajri SHEHU ***(kryeredaktor)***
H. Vullnet MERJA ***(zëvendëskryeredaktor)***
H. Jetmir ÇELA ***(sekretar i redaksisë)***
Prof. dr. Bedri BYLYKU ***(anëtar)***
Prof. dr. Feti MEHDIU ***(anëtar)***
H. Sulejman efendi REXHEPI ***(anëtar)***
H. Selim STAFA ***(anëtar)***

**Redaktore letrare:** Liseda RAMAJ

**Përkthyes të përmbledhjeve:** Mentor ÇADRI, Jetmir

ÇELA

©: Fondacioni i Kur'anit

Del katër herë në vit.

Viti V, 2012, Nr. 4 (22)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën "LILO"

**Adresa e redaksisë:**
Fondacioni i Kur'anit
Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

**THE LIGHT OF THE QUR'AN**
QUARTERLY SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC RESEARCHES AND STUDIES

**Director:** Prof. Mohammad Reza Haj Khezr

**Editorial Board:**

Prof. Dr. Hajri Shehu - **Editor-in-chief**
Haji Vullnet MERJA - **Deputy editor-in-chief**
Haji Jetmir ÇELA - **Secretary**
Prof. Dr. Bedri BYLYKU - **Member**
Prof. Dr. Feti MEHDIU - **Member**
Haji Sulejman ef. REXHEPI - **Member**
Haji Selim STAFA - **Member**

**Literary editor:** Liseda RAMAJ

**Summaries translators:** Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA

**Page setup:** Fatmir SHUTINA

©: Foundation of the Qur'an – Albania

No. 4, 2012 (22)

Printed in Albania by "LILO" Printing House

**Address of the Editorial Board:**
Fondacioni i Kur'anit
Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

# PASQYRA E LËNDËS

**Vullnet Merja**: Kur'ani – Libri i vërtetë dhe i të vërtetave..**9**

**Hossein Asadi**: Zemra sipas ajeteve të Kur'anit............**23**

**Gentian Asllani – Hajri Shehu**: Islami është kundër besimeve të kota.........................................................**39**

**Abduldaem Al – Kahiil**: Mashkulli nuk është si femra: ...**45**

**Harun Jahja**: Rruga që bën ushqimi në trupin tonë...**56**

Argumente shkencore në Kur'an për mjekësinë........**72**

**Ibrahim B. Sied**: Ndikimi i Islamit në mjekësinë botërore.................................................................**80**

**Muxhtaba Musavi Lari**: Pasuria në zemrat e maleve...**92**

**Edmir Maxharri**: Jeta dhe veprat e H. Ali Korçës......**99**

Bibliografi e revistës "Drita e Kur'anit", 2012..........**114**

**Veprimtari kur'anore**................................................**119**

**Përmbledhjet në gjuhën angleze...............................123**

**Përmbledhjet në gjuhën arabe.................................129**

# TABLE OF CONTENTS

**Vullnet Merja**: Qur'an is the Genuine Book and the Book of Truths..........9

**Hossein Asadi**: The Heart According to the Verses of Qur'an..........23

**Gentian Asllani - Hajri Shehu**: Islam is Against Superstitions..........39

**Abduldaem Al – Kaheel**: A Male is not like a Female: A New Scientific Vision..........45

**Harun Yahya**: The Food Path through the Digestive System in the Human Body..........56

Scientific Arguments in the Qur'an on Medicine.........72

**Ibrahim B. SIED**: Impact of Islam in the World Medicine...80

**Mujtaba Musavi Lari**: Wealth in the Hearts of the Mountains..........92

**Edmir Maxharri**: The Life and Works of Hafiz Ali Korca...99

Bibliography of "Drita e Kur'anit", 2012..........114

**Qur'anic Activities**..........119

**Summaries in English**..........123

**Summaries in Arabic**..........129

# قائمة المحتويات


وُلْنَتْ مَرْيا القرآن كتاب الحق والحقائق.......... 9

الحاج حسين الاسدى القلب حسب آيات القرآن.......... 23

گنتيان آسلاني و خيري شهو الإسلام ضد الاعتقادات الباطلة.......... 39

عبد الدائم الكحيل "وليس الذَّكَرُ كالأُنْثَى" - رؤية علمية جديدة.......... 45

هارون يحيى الطريق الذي يقطعه الطعام في جسدنا.......... 56

ادلة علمية حول الطب فى القرآن.......... 72

إبراهيم ب. سيد تأثير الإسلام في الطب العالمي.......... 80

مجتبى الموسوي اللاري الثروة في قلب الجبال.......... 92

أدمير ماجاري حياة الحافظ علي كورچا وآثاره.......... 99

بيان المقالات القرآنية المطبوعة فى مجلة "نور القرآن" من خلال السنة 2012 ... 114

نشاطات علمية و قرآنية.......... 119

ملخص باللغة الانگليزية.......... 123

ملخص باللغة العربية.......... 129

**Vullnet Merja**

# Kur'ani – Libri i vërtetë dhe i të vërtetave

## Abstrakt

*E vërteta më e madhe ka qenë, është dhe do të mbetet Kur'ani i shenjtë, për të cilin, Allahu i Madhëruar thotë:* ***"Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtra nga asnjëra anë. Kjo është Shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdërimet."*** *(Sure "Fusilet", ajeti 42) Dhe:* ***"Dhe thuaj: 'E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë.'"*** *(Sure "Kehf", ajeti 29) Askush nuk mund të udhëzohet në errësirë. Vallë a keni provuar të shihni ndonjë gjë pas ndërprerjes së energjisë dhe fikjes së dritës? Kur'ani është drita. "***Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."*** *(Sure "Bekare", ajeti 2)*

**1-** Si e ka cilësuar Kur'ani veten e tij? Çfarë fitojmë prej këtij cilësimi?
**2-** Profeti Muhamed dhe familja e tij e pastër janë kujdesur dhe janë interesuar shumë për Kur'anin. Çfarë kanë thënë ata për Kur'anin? Si bashkëpunonin ata me të?
**3-** Kur'ani i shenjtë na ka mësuar rrugët e bashkëpunimit me të. Cilat janë rugët e bashkëpunimit me Kur'anin?
**4-** Të shumtë janë ata që e neglizhojnë Kur'anin dhe e nënvleftësojnë atë? Si i kritikon Kur'ani këta njerëz? A jemi ne prej tyre?

**5-** Kur'ani është libri i jetës. Si ta bëjmë Kur'anin shoqërues të jetës tonë? Cilat janë rrugët më të mira për ta zbatuar Kur'anin, sidomos te të rinjtë?
**6-** Libri ynë, Kur'ani, ka të drejta. Si ta shlyejmë të drejtën e Kur'anit?
**7-** Kur'ani është shkollë. Si duhet të hyjmë në këtë shkollë që të ndërtojmë personalitetin tonë?

## 1- **Si e ka cilësuar Kur'ani veten e tij? Çfarë fitojmë prej këtij cilësimi?**

Kur'ani na e ka paraqitur veten e tij me emra të ndryshëm. Emrat e tij nuk janë, thjesht emra. Janë emra që kanë kuptime dhe dimensione të ndryshme. Çdo emër prej emrave të Kur'anit tregon një të vërtetë.

Kur'ani është dritë *(nurun)* që shkatërron dhe zhduk errësirat që mbulojnë zemrën. Ndriçon ndjenjat dhe hap horizontet e të menduarit. Rrethon shpirtin duke e rifreskuar dhe ringjallur atë. Ai na zbulon rrugët e lëvizjeve tona. **"...Juve ju erdhi prej Allahut dritë dhe Libër i qartë** (Kur'ani)." (Sure "Maide", ajeti 15).

**Kur'ani është syri i brendshëm** *(basireh)* me anë të të cilit shohim të vërtetën dhe të mirën e i ndjekim ato. Shikojmë të shtrembëruarën dhe të keqen dhe largohemi prej tyre. Ashtu siç ka nevojë syri i jashtëm për dritë që të shohë, edhe Kur'ani është basiret: **"Ky Kur'an është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që kanë besim të palëkundur.** (Sure "Xhathijeh", ajeti 20).

**Kur'ani është udhëzim** (udhëzues) *(hadij)* në rrugën e drejtë e të vërtetë. Askush nuk mund të udhëzohet në errësirë. Vallë a keni provuar të shihni ndonjë gjë pas ndërprerjes së energjisë dhe fikjes së dritës? "**Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai**

**është udhërrëfyes për të devotshmit."** (Sure "Bekare", ajeti 2). Ne i shohim gjërat të qarta nëpërmjet dritës së Kur'anit dhe kështu ai na udhëzon në rrugën e drejtë.

**Kur'ani është i qartë** *(bejjinat).* E qarta është diçka e dukshme. E qarta nuk mund të jetë në errësirë. Që diçka të jetë e qartë, duhet të jetë në dritë ose nën dritë. Prandaj, të gjitha ajetet e Kur'anit janë të qarta - sepse janë të ndriçuara me dritën e tij.

**Kur'ani është shërues** *(shifaa).* Për shërim ka nevojë i sëmuri. Në këtë jetë ka mashtrim, vjedhje, prostitucion, kamatë, armiqësi dhe të këqija të tjera. Kur'ani shëron smirën, xhelozinë, urrejtjen, armiqësinë, përbuzjen, racizmin, fanatizmin etj. Në Kur'an është shëndeti ynë - individual dhe shoqëror. **"O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kur'ani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët."** (Sure "Junus", ajeti 57).

**Kur'ani është mëshirë** *(rahmetun).* Ai është porta e madhe dhe e gjerë në të cilën hyjmë kur na mbyllen dyert e tjera. Ai është freski në të cilin strehohemi prej nxehtësisë, është dashuri kur na ngushtohen gjokset. Mëshira është mirësi e dukshme dhe e padukshme, begati e brendshme dhe e jashtme. **"...Ju ka ardhur nga Zoti juaj provë e qartë, udhërrëfim dhe mëshirë!..."** (Sure "En'am", ajeti 157).

**Kur'ani është forcues** *(muthbitun).* Sfidat, vështirësitë, problemet, fatkeqësitë, padrejtësitë, tërmetet shoqërore, ekonomike, politike dhe psikike, sprovat dhe privimet e hidhura që shohim në këtë jetë kanë nevojë për forcues, që qenia jonë të mos ndryshket e të mos rrënohet. E, ky forcues është Fjala e Allahut, Kur'ani i shenjtë. **"Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu."** (Sure "Furkan", ajeti 32).

**Kur'ani është përmendje** *(dhikr).* E kundërta e përmendjes (*dhikrit*) është pavëmendshmëria (*gafleti*).

Pavëmendshmëria, harresa, zbavitja janë devijim nga burimet e dritës, mëshirës dhe udhëzimit. Kurse dhikri është njëlloj si kthimi i makinës që del nga rruga për në rrugë. Nëse shoferi është i pavëmendshëm ndaj saj, e çon në rrezik, që mund t'i kushtojë edhe jetën. Dhikri është zgjim i mendjes e i zemrës dhe sinjalizues për shpirtin. Kur'ani na kujton gjithmonë se është Zoti që ruan, mëshiron, sheh, mbarëson, forcon, ndihmon, dënon. Ai na udhëzon në rrugën e paqes, të mirësisë dhe të lumturisë. **"Në të vërtetë, ky Kur'an është dhikër për tërë botën!"** (Sure "Sad", ajeti 87).

**Kur'ani është kujtesë.** Shumë herë ne i harrojmë ose na bën djalli që t'i harrojmë Zotin tonë, fenë tonë, përgjegjësitë tona, qëllimin e krijimit tonë, mësimin e Librit tonë. Ajetet e Kur'anit janë kujtuese për ato që ne harojmë. **"Si udhërrëfyes dhe përmendës për mendarët."** (Sure "Gafir", ajeti 54). Kur ndahesh nga një shok i dashur dhe ti nuk i telefonon, nuk i dërgon ndonjë mesazh a letër dhe as nuk i rigjallëron kujtimet e tua me të, dalangadalë ai të del nga kujtesa dhe jeta jote. I tillë është edhe Kur'ani. Ai është përmendës për përmendësit. Përndryshe, ai të shkëputet nga jeta jote dhe ti shkëputesh prej tij.

**Kur'ani është këshillë** *(meuidhetun).* Ai është këshilla e përkryer. Asnjë hulumtues nuk gjen këshillë më elokuente se sa Kur'ani. Kur'ani na flet për kombet e shkuara, për vdekjen, shijen e së cilës do ta provojmë të gjithë. Ai na flet për këtë jetë, e cila është veçse kënaqësi e përkohshme dhe vendzbavitje. **"Këto janë lajme të qarta për njerëzit. Janë udhëzim dhe këshillë për të devotshmit."** (Sure "Ali imran", ajeti 138).

**Kur'ani është sqarues i çdo gjithçkaje** *(Tibjanen li kul-li shej'in).* Ai përfshin gjithçka. Ai është burimi ku drejtohen të eturit e dijes, të njohjes dhe të moralit. Në të ka çështje themelore e madhore. Po të mos ishte i tillë, do të

kishim nevojë për libër tjetër. **"...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje..."** (Sure "Nahl", ajeti 89.)

**Kur'ani është sjellës i shëmbëllimeve** *(tesriful emthal)*. Shëmbëllimi është përngjasimi i një gjendjeje me një gjendje tjetër. Kur'ani i sjell këto shëmbëllime për të nxjerrë mësime. Të shkuarit jetuan nën dritën e asaj që deshi Allahu dhe u larguan prej asaj që i ka urdhëruar të largohen. Pa dyshim që në këtë ka mësime për ne. Kjo është arsyeja që Kur'ani na flet për historinë e të shkuarve dhe na fton të mendojmë thellë në punët dhe në fundin e tyre. **"Sigurisht, në këtë Kur'an, Ne u kemi shpjeguar njerëzve çdo lloj shembulli..."** (Sure "Kehf", ajeti 54.)

**Kur'ani është dallues i së mirës nga e keqja** *(furkan)*. Ai dallon të mirën nga e keqja, të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e padrejta, lumturinë nga fatkeqësia, dijen nga padituria, fuqinë nga dobësia, shpëtimin nga shkatërrimi. **"I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët."** (Sure "Furkan", ajeti 1) Nëse Kur'ani nuk do të dallonte dritën nga errësira, çdo gjë do të ishte e paqartë. Dritën do ta shihnim për errësirë dhe errësirën do ta shihnim për dritë. (siç bëjnë shumë njerëz sot!).

**Kur'ani është përgëzues** *(bushra)*. Ëshë përgëzues për myslimanët dhe për besimtarët, për atë që Allahu ua ka premtuar atyre prej shpërblimit të madh dhe begatisë së përhershme. **"...dhe përgëzues për myslimanët..."** (Sure "Nahl", ajeti 89.)

Këto janë disa cilësi të Kur'anit, të cilat i njohim nëpër-mjet tij.

## Si e ka cilësuar Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Kur'anin?

Janë përcjellë shumë thënie të Profetit rreth cilësimit që i ka bërë Kur'anit të shenjtë. Do të përmendim disa prej tyre.

Profeti e ka cilësuar Kur'anin *pasuri*: *"Kur'ani është pasuri dhe s'ka pasuri më të mirë se ajo dhe as varfëri pas kësaj pasurie."* Kjo do të thotë se njeriu nuk mund të mos kapet me Kur'anin dhe të mos e zbatojë atë. Dihet se pasuria e Kur'anit nuk është materiale. Ai është pasuri për mendjen sepse sjell dije dhe njohje për të. Është i pasur për zemrën sepse e furnizon me ushqim të rregullt psikik. Është pasuri për shpirtin sepse e ngre në shkallët e përsosurisë e të bindjes ndaj Krijuesit dhe e bën të jetë i shpëtuar dhe i lumtur në të dyja jetët. Është pasuri për jetën sepse tregon rrugëzgjidhjet për problemet dhe vështirësitë e saj.

Profeti e ka cilësuar Kur'anin *ilaç*. Kjo do të thotë se ai është farmacia që ka të gjitha llojet e ilaçeve, si për individët, ashtu edhe për shoqëritë. Kur i sëmuri merr ilaçin e duhur për shërim, ai qetësohet, sado e rëndë të jetë sëmundja.

Profeti e ka cilësuar Kur'anin të pashtershëm në mrekullitë e tij. Në Kur'an nuk ndodhet vetëm një çështje interesante dhe e mahnitshme. Të gjithë ajetet e tij janë interesante dhe të mahnitshme. Ato kanë qenë, janë dhe do të vazhdojnë të jenë të tilla. Na duhet t'i zbulojmë këto mrekulli. Sikur të na thuhej se në aksh ishull ka gjëra interesante dhe thesare të çmueshme, a nuk do të nxitonim për të shkuar tek to? E pse jo, edhe të përfitojmë prej tyre? Kur'ani është mbi pasuritë materiale të kësaj bote.

Mësimin e Kur'anit, Profeti i konsideron dallim mes myslimanëve, kur thotë: *"Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve."* Zbatuesit e tij i ka quajtur njerëzit më fisnikë. *"Më fisnikët e ymetit tim janë mbartësit e Kur'anit dhe ata që falin namazin e natës."*

Mbartja e Kur'anit ka kuptimin e zbatimit të tij. Moszbatimi i tij çon në atë që çoi bijtë e israilit për të cilët Kur'ani thotë: **"Shembulli i atyre, që iu besua Teurati,**

**por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat. Sa i keq është shembulli i atyre që mohojnë Shpalljet e Allahut! Allahu nuk i udhëzon të padrejtët."** (Sure "Xhumua", ajeti 5)

Thënia më madhështore e Profetit që duhet ta lexojmë me vëmendje dhe t'a zbatojmë në jetën tonë është: *"Unë kam lënë në mesin tuaj dy gjëra të çmuara - Librin e Allahut dhe familjen time."* Mbrojtja prej humbjes dhe devijimit nga rruga e Islamit pas profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) arrihet duke u kapur pas Kur'anit dhe prej atyre që e njohin më mirë atë.

Në hadithet e Ehli Bejtit, që janë hadithe të Profetit, thuhet se Libri (Kur'ani) është shërues i dyfytyrësisë, urrejtjes dhe politeizmit. Ai pastron zemrat. Ai shtë i ri në çdo kohë. Ai është shoqëruesi në vetmi. Imam Ali ibn Husejni (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Sikur të gjithë njerëzit të vdisnin e të qëndroja i vetëm, kurrë nuk do të frikësohesha, përderisa me mua është Kur'ani."*

Kushdo që e lexon Kur'anin, ose i shtohet udhëzimi ose i pakësohet verbërimi.

O Zot na e mundëso leximin, kuptimin dhe zbatimin e Kur'anit. Na i ndriço rrugët e jetës sonë me dritën e Kur'anit!

## Cilat janë rrugët e bashkëpunimit me Kur'anin?

Prej mirësive të Allahut të Madhëruar dhe prej mëshirës së Tij ndaj myslimanëve është se Ai u ka thënë atyre se si të bashkëpunojnë me Kur'anin. Ka shumë ajete që flasin për këtë çështje.

1- **Persiatja:** Allahu i Madhëruar thotë: **"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"** (Sure "Muhamed", ajeti 24).

Zemrat e kyçura janë si shtëptië e kyçura. Çdo gjë e saj është e mbyllur. Vallë, a mundet që rrezet e diellit, drita dhe ajri të hyjnë në të?! Zemrat e mbyllura nuk i pranojnë rrezet e dritës, as flladin e ajrit. Ato janë të ngjashme me varrezat ku jetojnë egërsira e krimba.

Zemra në të cilën nuk hyn drita dhe as flladet e Kur'anit, e ka ajrin të prishur dhe errësira e ka pushtuar. Është njëlloj si banesa e braktisur dhe e pabanuar.

2- **Kujtimi.** Allahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar. Prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!** (Sure "Kamer", ajeti 17).

Kur'ani është i qartë dhe i lehtë për t'u kuptuar. Përmbajtja e tij është prej Allahut. Kjo përmbajtje ka si qëllim ta nxjerrë njeriun prej rrethit të pavetëdijes në lulishten e vetëdijes, të kujtesës dhe të zgjimit.

Që Kur'anin ta lexojmë me përsiatje dhe arsyetim, duhet sipas kohës dhe situatës sonë. Për këtë Allahu thotë: **"...Kështu që lexoni Kur'an aq sa mundeni!..."** (Sure "Muzemmil", ajeti 20). Kjo do të thotë se nuk ka kufizim të caktuar për të lexuar Kur'anin. Nuk është e rëndësishme sasia e kohës së leximit, por cilësia e tij. Duhet që leximi të jetë i shoqëruar me persiatje dhe arsyetim. Kur'ani duhet lexuar ngadalë dhe pak e nga pak, siç thotë edhe Allahu i Madhëruar: **"Ky është një Kur'an, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t'ua mësosh njerëzve pak nga pak..."** (Sure "Isra", ajeti 106). Kështu që myslimanët ta mësojnë ashtu siç duhet. Në jetëshkrimin e Profetit thuhet se ai u mësonte myslimanëve dhjetë ajete. Kur ata i mësonin ato, u mësonte dhjetë të tjera. Mësimi nuk ishte vetëm me mësimin përmendsh të fjalëve dhe të kuptimeve. Ai bazohej edhe në zbatimin e ajeteve.

3- **Kërkimi i mbrojtes para leximit**. Allahu i Madhëruar thotë: **"Kur dëshiron të lexosh Kur'anin, kërko mbrojtjen e**

**Allahut kundër djallit të mallkuar."** (Sure "Nahl", ajeti 98.) Është misioni i djallit që të na largojë prej kryerjes së punëve të mira, që na afrojnë tek Allahu. Në Kur'an thuhet: **"Ai tha: "Për shkak se Ti më flake tej, unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë."** (Sure "A'raf", ajeti 16). Prandaj, që të hyjmë pa pengesa në botën e Kur'anit, duhet t'i kërkojmë Allahut mbrojtje prej djallit të mallkuar. Sigurisht, Allahu është Mbrojtësi më i mirë dhe Ai e largon djallin prej nesh kur i lutemi për këtë. Allahu thotë: **"Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo prej njerëzve!"** (Sure "Nas", ajetet 1-6). Mirëpo nuk duhet vetëm të shqiptojmë fjalët, por të mendojmë thellë për kuptimin e atyre që shqiptojmë, me qëllim që kuptimet e Kur'ant të nguliten thellë në zemrat dhe në mendjet tona. Ky është leximi e këndimi i kërkuar i Kur'anit dhe jo, thjesht lexim.

4- **Heshtja dhe dëgjimi me vëmendje**. Allahu i Madhëruar thotë: **"Kur të lexohet Kur'ani, dëgjoni dhe heshtni, që të mëshiroheni."** (Sure "A'raf", ajeti 204).

Dëgjuesi i Kur'anit me vëmendje dhe me përqëndrim e kupton më mirë Kur'anin dhe e ndien ëmbëlsinë e tij në shpirt dhe në zemër. Ka mundësi që një ajet ta kemi lexuar disa herë, por nuk ndikon tek ne ashtu siç mund të ndikojë dëgjimi me vëmendje nga një lexues me zë të bukur e prekës. Dëgjojmë e na duket se i kemi para syve ato pamje që dëgjojmë - të frikshme apo gëzuese qofshin ato. Ka raste kur dikush na këshillon për të bërë punë të mira; mirëpo nuk interesohemi dhe aq shumë për fjalët që na thotë. Ndërsa, kur e dëgjojmë një ajet të Kur'anit që na nxit për të bërë punë të mira, na jep zemër për të bërë punë të mira dhe për t'u larguar prej punëve

të këqija. Vërtet, Kur'anin e dëgjoi me vëmendje një grup prej xhindeve dhe e ndoqën atë. E dëgjuan një grup politesitësh të Mekës dhe e ndoqën. E dëgjuan jomyslimanët dhe e ndoqën. E ku ta dimë ne se sa ajete nga Kur'ani kanë ndryshuar jetën e njerëzve vetëm nga dëgjimi i tyre me vëmendje?

5- **Këshillimi me dijetarët.** Allahu i Madhëruar thotë: **"... Pyetni dijetarët e Librit, nëse nuk e dini** (këtë)**."** (Sure "Nahl", ajeti 43). Dhe: **"...Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu dhe ata që janë thelluar në dije..."** (Sure "Ali Imran", ajeti 7). Komentuesit kanë mendime të ndryshme se kush janë të thelluarit në dije. Por mendimi më i afërt është se janë imamët e Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi ta!), të cilët e kanë marrë dijen e Librit prej burimit të kthjellët e të pastër, që është Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Për këtë kohë, ka kuptimin e dijetarëve të ymetit, të cilët e kanë marrë dijen e Kur'anit nëpërmjet rrugëve të sakta e të konsiderueshme dhe thëniet, komentimet e shkrimet e tyre janë të zbrazëta prej imagjinatave, iluzioneve dhe ekstremizmave.

## Çfarë thotë Kur'ani për ata që e shpërfillin atë?

Kur'ani i qorton ata të cilët mbartin vetëm formën dhe fjalët e Kur'anit. Ndër to përmendim:

a- **Shpërfillja e Kur'anit**. Allahu thotë: **"Dhe i Dërguari do të thotë: "O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kur'anin, si (diçka) të urryer."** (Sure "Furkan", ajeti 30) Ata e kanë lënë pas dore Kur'anin. Nuk e vlerësojnë ashtu siç duhet vlerësuar. Nuk e lexojnë dhe nuk e përsiatin atë. Nuk e zbatojnë në jetën e tyre. Ata janë njëlloj si një njeri që ka një kështjellë të bukur e të gjerë dhe e ka lënë për të banuar në një kasolle të neveritshme.

**b- Mospërsiatja e tij.** Allahu i Madhëruar thotë: **"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"** (Sure "Muhamed", ajeti 24.)Mospersiatja ka kuptimin *"lexim sipërfaqësor i Kur'anit, pa u thelluar në kuptimet e ajeteve të tij."* Ky nuk është lexim cilësor. Është lexim që i mungon shpirti. Është lexim që nuk ndikon dhe nuk sjell reagim. Sepse sytë shikues të ajeteve janë në një anë dhe syri i zemrës është në një anë tjetrër! Sa habi e madhe!

**c- Besimi i një pjese të Librit dhe mohimi i një pjese tjetër të tij.** Allahu i Madhëruar thotë për jehudinjtë dhe të krishterët: **"Dhe e bënë Kur'anin në pjesë"** (duke i besuar ca pjesë dhe duke i mohuar të tjerat)." (Sure "Hixhr", ajeti 91). Sot shohim se myslimanët e kanë bërë të tillë Kur'anin. Ata besojnë në atë që u përputhen dëshirat, mendësia dhe lakmitë e tyre dhe mohojnë atë që është në kundërshtim me dëshirat, lakmitë dhe mendësinë e tyre. Këtë e kundërshton Kur'ani, duke thënë: **"...Mos vallë, një pjesë të Librit e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni...?!** (Sure "Bekare", ajeti 85.)

**ç- Shitja e ajeteve për vlerë të vogël.** Allahu i Madhëruar thotë: **"Ata i shesin fjalët e Allahut për një vlerë të vogël dhe i pengojnë njerëzit nga Rruga e Tij. Vërtet të shëmtuara janë veprat e tyre!"** (Sure "Teube", ajeti 9.) Ky ajet nuk ka të bëjë me jehudinjtë; ai përfshin çdo mysliman që pason dëshirat e shfrenuara dhe lakmitë, duke u bërë pjesë e atyre që luftojnë të fitojnë këtë jetë dhe humbasin Jetën Tjetër.

**d- Mospërputhja mes dijes për Kur'anin dhe zbatimit të tij.** Allahu i Madhëruar thotë: **"E si mund të mos besoni kur juve ju lexohen Shpalljet e Allahut...?!"** (Sure "Ali Imran", ajeti 101) Dija rreth ajeteve të Kur'anit çon në besim. Ata që i qorton Kur'ani janë prej atyre që e njohin rrugën, por devijojnë. E njohin dritën, por i mbyl-

lin sytë e tyre. E njohin shpërblimin, por këmbëngulin në gabime dhe gjynahe. Allahu i Madhëruar thotë: **"... Shiko si ua shpjegojmë atyre Shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta!"** (Sure "Maide", ajeti 75.). Një njeri që ka hartën treguese për të arritur diku e kërkon të mos e zbatojë atë dhe të ndjekë dëshirën e tij, a do të arrijë në atë destinacion?! Vërtet, ecja e tij e shumtë nuk do t'i sjellë veçse largim nga destinacioni dhe qëllimi.

**dh- Kundërshtimi dhe largimi prej mësimeve të Kur'anit.** Allahu i Madhëruar thotë: **"Sa herë që atyre** (jobesimtarëve) **u vjen ndonjë ajet nga Shpallja e Zotit të tyre, ata ia kthejnë shpinën."** (Sure "En'am", ajeti 4). Këta lloj njerëzish nuk duan t'ia dinë për urdhëresat dhe ndalesat e Kur'anit. Ata janë krejt të pavëmendshëm ndaj Fjalës së Allahut të Madhëruar. Kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Kanë sy, por nuk shikojnë. Kanë mendje, por nuk mendojnë.

**e- Mosndikimi.** Ka njerëz që e lexojnë Kur'anin a e dëgjojnë atë, por fjalët e tij (Kur'anit) hyjnë te njëri vesh dhe dalin tek tjetri, pa bërë asnjë ndikim në mendje, në zemër dhe në shpirt. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë...?!"** (Sure "Hadid", ajeti 16.) Ka raste që lexojmë një roman dhe ndikohemi nga ndonjë prej personazheve, a na lotojnë sytë kur shohim një skenë fatkeqësie, a inkurajohemi kur lexojmë vargje poemash e poezish, a na lëkunden ndjenjat kur dëgjojmë një këshillë. Vallë, a na ndodh kështu kur lexojmë Kur'anin? A na kanë lotuar ndonjëherë sytë kur kemi lexuar ajetet e dënimit? A është gëzuar zemra jonë kur kemi lexuar ajetet e Xhennetit? A është frikësuar zemra jonë e na janë zbutur ndjenjat tona kur lexojmë

ajetet e këshillave e të porosive të Krijuesit tonë? Sikur të mendohemi në thënien e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), *"Unë, vërtet habitem pse nuk thinjem kur lexoj Kur'anin"*, do të mësojmë se leximi i thellë, i shoqëruar me meditim ndikon thellë në brendinë e njeriut dhe në jetën e tij.

## Si ta bëjmë Kur'anin shoqërues në jetën tonë?

Si mund ta bëjmë Kur'anin të ecë në jetën tonë siç ecën uji në lumenj, a siç ecën gjaku nëpër damarë, a siç ecën dielli dhe hëna, nata dhe dita? Cilat janë mënyrat e reagimit ndaj Kur'anit në këto kohët e sotme? **Provo që ajetet e Kur'anit të të tërheqin njëlloj, siç të tërheq një tablo e bukur dhe ti e shikon me shumë vëmendje.**

**Ka mundësi që shoqërimi me Kur'anin është i gjatë, por përqendrimi në të nuk ka ndodhur. Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Kur'ani nuk lexohet me nxitim, por lexohet ngadalë. Kur të arrish tek ajeti që flet për Xhennetin, qëndro dhe iu lut Allahut, që të të fusë në të. Kur të arrish në një ajet ku përmendet zjarri, lutju Allahut, që të mbrojë prej zjarrit."**

**Këtë mënyrë të leximit që përmend imam Sadiku, mund ta zgjerojmë edhe si vijon:**

**Kur të arrish në një ajet ku përmendet kërkimi i faljes, lutju Allahut që të t'i falë mëkatet dhe gjynahet.**

**Kur të arrish në një ajet ku përmendet mëshira, kërkoji mëshirë Allahut, sepse Ai është i Gjithmëshirëshmi dhe Mëshirëploti.**

**Kur të arrish në një ajet që flet për të shkuarit dhe se çfarë u ndodhi atyre, mendo sikur të ishe ti njëri prej tyre.**

**Kur të arrish në një ajet që flet për falënderimin, kujto mirësitë që Allahu të ka dhënë dhe falënderoje**

**Atë për ato dhe lutju Atij që të të mirësojë gjithmonë.**

**Kur të arrish në një ajet që flet për pendimin, pendohu tek Allahu me pendim të çiltër e të pakthyeshëm.**

**Kur të arrish te një ajet që fton në punë të mira, thuaj: "I përgjigjem thirrjes Sate, o Allah."**

**Kur të arrish në një ajet që është lutje, lutu me atë lutje si kërkues.** E kështu me radhë.

Nëse do të përfitosh sa më shumë prej ajeteve të Kur'anit, mendo thellë për përmbajtjen e tyre. S'ka dyshim se i gjithë Kur'ani na jep çelësat e veprave. Ai na tregon, na udhëzon.

Kur'ani është libri i vërtetë dhe i të vërtetave. Që në kohën e krijimit në këtë tokë  njeriu ka kërkuar të vërtetën. E vërteta më e madhe ka qenë, është dhe do të mbetet Kur'ani i shenjtë, për të cilin Allahu i Madhëruar thotë: **"Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtra nga asnjëra anë. Kjo është Shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdërimet."** (Sure "Fusilet", ajeti 42)

Dhe: **"Dhe thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë."** (Sure "Kehf", ajeti 29)

**Haxhi Hossein Asadi**

# Zemra sipas ajeteve të Kur'anit

## Abstrakt

*Zemra në Kur'an paraqitet si qendra e natyrës së njeriut dhe vendi i mishërimit të shpirtit. Zemra është qendra më e afërt për lidhjen e njeriut me Origjinën e Krijimit. Zemra ka "sy dhe veshë", ajo shikon dhe dëgjon. Sipas Kur'anit, në qoftë se njeriu nuk beson me zemër, atëherë ai nuk është* ***besimtar:*** *"Beduinët thanë:* ***'Ne kemi besuar!' Thuaj: 'Ju nuk keni besuar ende, por thoni: Ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja. E nëse e respektoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është shumë Mëkatfalës, shumë Mëshirues.'*** *" (Sure "Huxhurat", ajeti 14)*

Zemra në Kur'an paraqitet si qendra e natyrës së njeriut dhe vendi i mishërimit të shpirtit. Zemra ka një kuptim më specifik dhe më të kufizuar se "uni" ose ndërgjegjja. Zemra, sipas këndvështrimit kur'anor, është po ai organ fizik që gjendet në kraharorin e njeriut. Ndërsa gjendjet e zemrës janë frika dhe ankthi, zhgënjimi dhe dëshpërimi, qetësia, gëzimi etj. Të gjitha këto gjendje kanë ndikim konkret mbi zemrën. Zemra është origjina dhe burimi i së mirës dhe i së keqes, vendi i ndjenjave, i emocioneve dhe i prirjeve të tjera të karakterit njerëzor. Qëllimi dhe synimi, vullneti dhe dëshira e lirë kanë lidhje me zemrën dhe nga kjo anë, përgjegjësia e të gjitha vepri-

meve të njeriut, ka të bëjë ose është e drejtuar nga zemra e tij, ndërsa vetë njeriu është përmbushës i kërkesave që kërkon zemra. Nga ana tjetër, zemra është dhe qendra e njohjes dhe e kuptimit të gjërave të dukshme, si dhe vendi ku buron frymëzimi apo vendoset lidhja me hyjnoren, gjithashtu është edhe vendi ku vendoset lidhja me botën e fshehtësisë dhe të mbinatyrshmes. Zemra ka "sy dhe veshë", ajo shikon dhe dëgjon, ndërsa ndërgjegjja e njeriut është e vendosur nën urdhrat e arsyes dhe të ligjeve të moralit, shoqërisë apo fesë. Njeriu, i cili ecën në rrugën e së mirës dhe përsosurisë, i dorëzohet së Vërtetës (Hakut) duke arritur tek njohja e zemrës. Ai njeriu thotë të vërtetën dhe dëgjon të vërtetën duke u kthyer në qendër të së vërtetave të botës dhe atëherë këtij njeriu i thuhet "zotërues i zemrës së urtë". Por, nëse njeriu do të ndjekë epshet, do të tallet me arsyen e tij. Atëherë, ai bëhet skllav i epsheve, zhytet thellë në botën e gjynaheve, i verbohen sytë dhe i shurdhohen "veshët" e zemrës dhe mbyll kështu me duart e veta dritaret dhe dyert e njohjes dhe të perceptimit të zemrës së tij. Ai e humbet edhe mundësinë për të dalluar të vërtetat e botës. Në këtë mënyrë, ai i largohet edhe besimit në Zot, duke humbur njëherësh edhe të mirat e begatitë e mëshirës së Allahut. Tashmë, zemra e tij kthehet në kryeqendër të së keqes, të tundimeve djallëzore dhe bëhet skllave e epshit e dalëngadalë krijohen edhe kushtet e mjerimit të njeriut. Ky njeri kurrë nuk do ta njohë dhe nuk do t'i ndjekë të Vërtetën dhe Zotin. Zemra është burimi më i rëndësishëm i ekzistencës së shpirtit dhe qendra e të gjitha kuptimeve dhe e veprave të mira a të këqija të njeriut.

***"Kur ata ju erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajonit mendime të llojllojta për Allahun."*** (Sure "El Ahzab", ajeti 10)

Nëse në zemrën e njeriut do të krijohen kushtet për shfaqjen e së mirës, atëherë Zoti do të derdhte bekimet më të mira drejt tij.

***"O Pejgamber! Thuaju atyre robërve që i keni në duart tuaja, se sapo të vërejë Allahu ndonjë të mirë (besim të drejtë e të sinqertë) në zemrat tuaja, Ai ju jep edhe më shumë të mira nga ajo çka është marrë nga ju, ua falë gabimet, se Allahu falë pa masë, se është Mëshirues i Madh."*** (Sure "El Enfal", ajeti 70)

Sipas Kur'anit, në qoftë se njeriu nuk beson me zemër, atëherë ai nuk është ***besimtar.***

***Beduinët thanë: "'Ne kemi besuar!' Thuaj: 'Ju nuk keni besuar ende, por thoni: Ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja. E nëse e respektoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është shumë Mëkatfalës, shumë Mëshirues.'"*** (Sure "Huxhurat", ajeti 14)

Vetëm pastërtia dhe çiltërsia e zemrës bëhen shkak i shpëtimit dhe i lumturisë së njeriut.

***"Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët... (Bën dobi) vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë."*** (Sure "Shuara", ajetet 88-89)

## Njohja e vërtetë e zemrës dhe kuptimet e saj

***"Zemra nuk mohoi atë që pa (me sy)."*** (Sure "Nexhm", ajeti 11)

***"Pse në të vërtetë, sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharor."*** (Sure "El Haxh", ajeti 46)

Gjynahu, padija dhe shmangia nga ligjet e Krijimit bëhen shkak i mungesës së arsyes dhe i njohjes së zemrës. Atëherë, zemra mbulohet nga perdet dhe bëhet vendi e preja e tundimeve djallëzore.

***"Ka prej tyre që ty të dëgjonë (kur lexon Kur'anin).***

***Po Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim dhe edhe sikur t'i shohin të gjitha faktet, ata nuk besojnë, derisa kur vijnë te ti e të polemizojnë, ata që mohuan thonë: 'Nuk është tjetër ky (Kur'ani) vetëm se mit i hershëm.'"*** (Sure "En'nam", ajeti 25)

***Thuaj: "Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve, Sunduesin e njerëzve, të Adhuruarin e njerëzve prej së keqes së cytësit që fshihet, i cili bën cytje në zemrat e njerëzve, qoftë ai (cytësi) nga xhindet ose nga njerëzit."*** (Sure "En Nas", ajetet 1-6)

Zemra është vendi i lidhjes së besës me Zotin. Profetët njoftohen për besën e tyre me anë të zemrës. ***"Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). (E solli) në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber)."*** (Sure "Shuara", ajetet 193-194)

Zemra është qendra më e afërt për lidhjen e njeriut me Origjinën e Krijimit.

***"O ju që besuat, përgjigjjuni (thirrjes së) Allahut dhe të të Dërguarit kur ai (i Dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë) dhe ta dini se Allahu ndërhyn ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij dhe se ju do të tuboheni tek Ai."*** (Sure "El Enfal", ajeti 24)

Zemra është rrugë kalimi, bekimi dhe bujarie nga Zoti për besimtarin.

***"Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin. Ushtritë e qiejve e të tokës janë vetëm të Allahut, e Allahu është shumë i Ditur dhe shumë i Saktë.*** (Sure "El Fet'h", ajeti 4)

Zemra është vendi i fshehjes së frikës dhe ankthit të jobesimtarëve.

***"Ne do to mbjellim frikën në zemrat e atyre që nuk besuan sepse ata Allahut i trillojnë e i mveshin zota të tjerë, duke mos pasur për këtë kurrfarë fakti, ndaj vendbanimi***

***i tyre do të jetë Xhehenemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve."*** (Sure "Ali Imran", ajeti 151)

## Zemra e njeriut provohet nga Zoti

Pastaj, pas asaj tronditjeje të rëndë, Ai ju lëshoi sa për qetësim një kotje (gjumë të lehtë), që i kaploi një grup prej jush, kurse një grup i kishte preokupuar vetëm çështja e vetvetes. Ata formuan bindje të padrejtë për Allahun, bindje injorante, e thonin: "Ne nuk kemi në dorë asgjë nga kjo çështje"! Thuaj: "E tërë çështja është vetëm në duar të All'llahut"! Ata fshehin në vetvete atë që ty nuk ta shprehin. Thonin: "Sikur ne të kishim diçka në dorë në këtë çështje, ne nuk do të mbyteshim këtu"! Thuaj: "Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, atyre që është caktuar mbytja (vdekja), do të dilnin në vendin e flijimit të tyre"! Në mënyrë që Allahu të provojë atë që është në zemrat e tuaja (sinqeritetin ose hipokrizinë) dhe që ta pastrojë atë që është në zemrat tuaja. Allahu i di shumë mirë të fshehtat në zemra.

## Gjendjet negative të zemrës që përmenden në Kur'an

1.Dyfytyrësia: ***"Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, përveç mashtrimit!'"*** (Sure "El Ahzab", ajeti 12)

2.Shmangia (nga Rruga e Drejtë): ***"Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i***

***komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: "Ne i besojmë (Kur'anit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!" Këtë e kuptojnë vetëm mendarët."*** (Sure "Ali Imran", ajeti 7)

3.Inati dhe zilia: ***"Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: 'O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!'"*** (Sure "El Hashr", ajeti 10)

4.Pluhuri dhe ndryshku që vijnë për arsye të gjynaheve dhe mospëlqimit të së mirës: ***"Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat. Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t'i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre..."*** (Sure "El Mutaffifine", 14-15)

5.Ashpërsia: ***"Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai."*** (Sure "Ali Imran", 159)

6.Ngurtësia: ***"A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?!) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë!"*** (Sure "Ez Zumer", 22) ***"Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja."*** (Sure "El Bekare", 74)

7.Mbyllja e zemrës: "***Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!***" (Sure "Muhammed", 24)

8.Mbulesa dhe perdja: "***Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!***" (Sure "El Bekare", 7)

9.Dyshimi: "***Ty do të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit dhe që zemrat e tyre dyshojnë. Ata luhaten në dyshimin e vet.***" (Sure "Et Teube", 45)

10.Mendimi për të keq: "***Gjithashtu, (Ai e bëri këtë) për t'i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtaret, që mendojnë keq për Allahun. Radha e fatkeqësisë le t'i godasë ata! Allahu është zemëruar me ata, i ka mallkuar dhe u ka përgatitur Xhehenemin; eh, sa vend i shëmtuar që është ai!***" (Sure "El Fet'h", 6) "***Jo! Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të kthehen kurrë te familjet e tyre dhe zemrat tuaja ishin të kënaqura me këtë trill. Ju ushqyet mendime shumë të këqija dhe kështu u bëtë popull i pavlefshëm i nisur drejt shkatërrimit.***" (Sure El Fet'h, 12)

11.Neglizhenca për të përmendur Zotin: "***Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.***" (Sure "El Kehf", 28)

12.Shpërqendrimi i zemrës: "***Ata nuk do të luftojnë kundër jush së bashku, veçse në vende të fortifikuara ose pas mureve. Lufta ndërmjet tyre është e ashpër. Ti mendon se ata janë të bashkuar, mirëpo zemrat e tyre janë të përçara, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë.***" (Sure "El Hashr", 14)

13.Epshet e zemrës: *"Sa herë që atyre u vjen nga Zoti i tyre ndonjë paralajmërim i ri, ata e dëgjojnë, duke u tallur me të."* (Sure "El Enbija", 2)

14.Gjynahu: *"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm."* (Sure "En Nisa", 48) *"Me të vërtetë, ata që shpifën, janë një skotë prej jush. Mos e quani atë si të keqe për ju. Përkundrazi, kjo është mirë për ju. Çdonjëri prej tyre do të dënohet për atë që ka bërë, kurse atë që ka shpifur më shumë, e pret një dënim i madh."* (Sure "En Nur", 11)

15.Frika dhe stresi: *"Ne do të mbjellim frikë në zemrat e jobesimtarëve, sepse ata adhurojnë veç Allahut gjëra, për të cilat Ai nuk ka sjellë kurrfarë prove. Vendbanimi i tyre është zjarri e sa vendstrehim i shëmtuar është ky për keqbërësit!"* (Sure "Ali Imran", 151)

16.Dëshpërimi: *"O besimtarë! Mos bëni si ata jobesimtarë (hipokritët) që u thonin vëllezërve, kur këta niseshin në udhëtim ose në luftim: 'Sikur të rrinit me ne, as nuk do të vdisnit, as nuk do të vriteshit!'- që këtë Allahu ta kthejë si pikëllim në zemrat e tyre. Allahu është Ai që jep jetën dhe sjell vdekjen; Allahu i sheh të gjitha punët që bëni ju."* (Sure "Ali Imran", 156)

17.Urrejtja për drejtësinë dhe të vërtetën: *"Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë në jetën tjetër neveriten, ndërsa, kur përmenden të tjerët, përveç Allahut, ata menjëherë gëzohen."* (Sure "Ez Zumer", 45)

18.Cektësia: *"Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë."* (Sure "El En'am", 125)

## Gjendjet pozitive të zemrës

1.Zemërgjerësia: ***"(Musai) tha: 'O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim!'"*** (Sure "Ta Ha", 25)

2.Fuqia e zemrës dhe vullneti: ***"Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: "Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t'i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe."*** (Sure "El Kehf", 14)

3.Zemërbutësia: ***"Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kuranin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu. Ky Libër është udhëzim i Allahut. Nëpërmjet tij Allahu udhëzon kë të dojë. Ndërsa atë që Allahu e shpie në humbje, s'mund ta udhëzojë kush."*** (Sure "Ez Zumer", 23)

4.Dorëzimi përpara së Vërtetës: ***"Pa dyshim që një nga ithtarët e (besimit të) tij (Nuhut) ishte Ibrahimi. Ai i erdhi Zotit të vet me zemër të pastër…"*** (Sure "Es Saffat", 83-84)

5.Qetësia e zemrës: "*…**ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!"*** (Sure "Err Rrad", 28)

6.Përulja ndaj Krijuesit: "*…**atyre, zemrat e të cilëve frikësohen, kur përmendet Allahu, që (janë) të durueshëm për gjithçka që i godet, që falin namazet dhe që ndajnë nga ajo, që Ne ua kemi dhënë."*** (Sure "El Haxh", 35)

7.Malli për të Vërtetën: ***"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten."*** (Sure "El Enfal", 2)

8.Devotshmëria e zemrës: "***Po, kështu është! Ndërsa kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.***" (Sure "El Haxh", 32)

9.Devotshmëria dhe vëllazëria: "***Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.***" (Sure "Al Imran", 103)

10.Pendimi dhe kthimi te Zoti: "***…që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga Allahu).***" (Sure "El Kaf", 33)

**Shenjat e sëmundjeve të zemrës**

1.Dyfytyrësia në fjalë dhe në vendimmarrje: "***Kur takohen me besimtarët, ata thonë "Besojmë" – por, kur mbesin vetëm me djajtë e tyre, thonë: "Në të vërtetë, ne jemi me ju; ne vetëm po talleshim.***" (Sure "Bekare", 14)

2.Mohimi pas besimit: "***Kjo, sepse ata fillimisht besuan, pastaj mohuan, kështu që zemrat e tyre u vulosën dhe si pasojë ata nuk kuptojnë më.***" (Sure "Munafikun", 3)

3.Përgënjeshtrimi i së Vërtetës pas ardhjes së saj: "***Kujto kur Musai i tha popullit të vet: "O populli im, përse po më mundoni, kur e dini mirë se unë jam i dërguari i Allahut te ju?!" Kur ata u larguan (nga e vërteta), Allahu i largoi zemrat e tyre (nga rruga e drejtë); Allahu nuk e shpie në rrugë të drejtë popullin jobesimtar.***" (Sure Es Saf, 5)

4.Largimi dhe shmangia nga e Vërteta: "***Kush është më i padrejtë se ai që, kur ia kujtojnë shpalljet e Zotit të vet, largohet nga ato dhe harron se ç'kanë bërë duart***

***e tij më parë?! Ne kemi vënë perde në zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë (Kuranin), dhe ua kemi rënduar veshët. Edhe sikur ti t'i thërrasësh ata në rrugën e drejtë, ata kurrë nuk do të udhëzohen."*** (Sure "El Kehf", 57)

5.Keqinterpretimi i Fjalës së Vërtetë: ***"Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhamed) përherë do ta vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit."*** (Sure "El Maide", 13)

6.Tallja me pasuesit e së Vërtetës: ***"Sa për ata (hipokritë) që përqeshin besimtarët që japin lëmoshë me vullnet dhe tallen me ata që nuk janë në gjendje të japin gjë përveç (fryteve të) punës së tyre, Allahu do të tallet me ta. Ata do të kenë dënim të dhembshëm."*** (Sure "Et Teube", 79)

7.Ndjekja e dëshirave: ***"Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh?"*** (Sure "El Xhathije", 23)

8.Ndjekja e kënaqësive të kësaj bote: ***"Kënaqen të jenë me ata që nuk shkojnë në luftë, zemrat e tyre janë të vulosura e ata nuk kuptojnë!"*** (Sure "Et Teube", 87)

9.Mungesa e meditimit për ajetet dhe argumentet e Krijimit: ***"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"*** (Sure "El Muhamed", 24)

10.Mosbesimi në Ringjallje dhe në përjetësinë e shpirtit: ***"Zoti juaj është një Zot i vetëm. Ata që nuk besojnë në jetën tjetër, i kanë zemrat mohuese të së vërtetës dhe janë mendjemëdhenj."*** (Sure "En Nahl", 22)

11.Thyerja e besës: *"Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhamed) përherë do ta vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit."* (Sure "El Maide", 13)

12.Mendjemadhësia ndaj pranimit të së Vërtetës dhe debati pa argumente e pa vetëdije: *"Ata që i kundërshtojnë shpalljet e Allahut, pa pasur asnjë provë, janë të urryer në sytë e Allahut dhe në sytë e atyre që besojnë. Kështu, Allahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi e dhunuesi."* (Sure "El Gafir", 35)

13.Përtacia në zbatimin e detyrave: *"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur."* (Sure "El Hadid", 16)

14.Parapëlqimi i kësaj bote në vend të Botës së Përtejme: *"Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit, (do të dënohet ashpër), përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim. Ndërsa ata që ia hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh. Kjo, sepse ata e duan më shumë jetën e kësaj bote, sesa jetën e Botës Tjetër; Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë mohuesit.* Këta *janë ata të cilëve Allahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe të parët; pikërisht këta janë të shkujdesurit."* (Sure "En Nahl", 106-108)

15.Mosdashja e së Vërtetës: *"Nëse jeni në udhëtim e nuk gjeni shkrues, atëherë merrni peng. Dhe, nëse njëri prej jush ka besim tek tjetri, atëherë borxhliu le ta kthejë*

***atë që i është besuar dhe le t'i frikësohet Allahut, Zotit të vet. Mos e fshihni dëshminë, se, kush e fsheh atë, zemra e tij është gjynahqare. Allahu di çdo gjë që punoni ju."*** (Sure "El Bekare", 283)

16.Mospërmendja e Zotit dhe pasimi i jobesimtarëve: ***"Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta."*** (Sure "El Kehf", 28)

17.Kopracia: ***"Por kur Ai u dha atyre nga dhuntitë e Veta, ata u bënë kopracë dhe kthyen shpinën, duke u larguar. Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin dhënë Allahut. Ata e kishin zakon gënjeshtrën."*** (Sure "Et Teube", 76-77)

18.Ndërtimi i jetës pa devotshmëri është shkak i dyshimeve të përhershme të zemrës: ***"Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij apo ai që themelet e godinës së tij i vë në bregun e gërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës. Godina që ata ndërtuan, mbjell gjithnjë dyshim në zemrat e tyre, derisa zemrat e tyre t'u copëtohen. Allahu është i Gjithëditur, i Urtë."*** (Sure "Et Teube", 109-110)

19.Uni: ***"Sa herë që atyre u vjen nga Zoti i tyre ndonjë paralajmërim i ri, ata e dëgjojnë, duke u tallur me të. Zemrat e tyre janë të hutuara. Ndërsa ata që janë idhujtarë, flasin fshehurazi: "A është ky (Muhamedi) diçka tjetër, përveçse njeri si ju? Vallë, a do të shkoni ju pas magjisë (së tij), kur e shikoni me sytë tuaj?"*** (Sure "El Enbija", 2-3)

## Elementët e ringjalljes së zemrës

1.Besimi te Zoti: *"Çdo fatkeqësi që i bie njeriut, ndodh me vullnetin e Allahut. Ai ia udhëzon zemrën kujtdo që i beson Atij. Allahu di mirë çdo gjë."* (Sure "Et Tegabun", 11)

2.Mbështetja te Zoti: *"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten."* (Sure "El Enfal", 2)

3.Falja e namazit: *"...ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë."* (Sure "El Enfal", 3)

4.Dhënia për hir të Zotit: *"...dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre..."* (Sure "El Muminun", 60)

5.Kthimi te rruga e Allahut të Madhëruar: *"...që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kurnuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga Allahu)."* (Sure "El Kaff", 33)

6.Përmendja e Zotit: *"...ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!"* (Sure "Err Rrad", 28)

7.Durimi dhe mbështetja tek Allahu në vështirësi: *"...atyre, zemrat e të cilëve frikësohen, kur përmendet Allahu, që (janë) të durueshëm për gjithçka që i godet, që falin namazet dhe që ndajnë nga ajo, që Ne ua kemi dhënë."* (Sure "El Haxh", 35)

*"Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: "Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!"* (Sure "El Bekare", 155-156) Allahu i përgëzon durimtarët në këtë jetë dhe të udhëzuarit se Ditën e

Gjykimit do të kenë shpërblim të kënaqshëm: ***"Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!"*** (Sure "El Bekare, 157)

8.Dorëzimi përpara Urdhrit të Zotit: ***"A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur."*** (Sure "El Hadid", 16)

9.Respektimi i kufijve të Zotit: ***"O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"*** (Sure "El Ahzab", 32)

10.Udhëtimet dhe meditimet: "***Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor."*** (Sure "El Haxh", 46)

11.Nderimi i simboleve të fesë: ***"Po, kështu është! Ndërsa kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij."*** (Sure "El Haxh", 32)

12.Mendimi dhe arsyetimi për ajetet e Kur'anit: ***"Vallë, a nuk persiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!"*** (Sure "Muhammed", 24); ***"Askush nuk mund të besojë, përveçse me vullnetin e Allahut. Ai e zbret zemërimin e Tij mbi ata që s'mendojnë."*** (Sure "El Junus", 100)

13.Lufta e drejtë në rrugën e Zotit: ***"Luftoni kundër tyre, që Allahu t'i dënojë ata me duart tuaja, t'i poshtërojë, t'ju ndihmojë juve kundër tyre, t'i shërojë shpirtrat e besimtarëve dhe ta largojë hidhërimin nga zemrat e tyre! Allahu ia pranon pendimin kujt të dojë. Allahu është i***

***Gjithëditur dhe i Urtë."*** (Sure "Et Teube", 14-15)

14.Sakrifica për Zotin: ***"Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës. Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcuam në rrugën e drejtë. Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: "Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t'i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe."*** (Sure "El Kehf", 13-14)

15.Miqësi dhe armiqësi për hir të Zotit: ***"Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese."*** (Sure "El Muxhadele", 22)

16.Besimi tek i Dërguari i Zotit dhe besëlidhja me të: ***"Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt."*** (Sure "El Fet'h", 18)

17.Shpejtimi për të kryer vepra të mira: ***"...kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre. Ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët."*** (Sure "El Mu'minun", 60-61)

**Gentian Asllani – Hajri Shehu**

# Islami ëshë kundër besimeve të kota

**Abstrakt**

*Besimet në horoskopin, në "ditën ters" (dita e martë) , në shenjat "që sjellin fatkeqësi" etj., megjithëse duken të vogla, në të vërtetë, janë shkatërrueset e themelit të besimit të një myslimani, janë shkatërrueset e besimit në një Zot. Besime të tilla mund të ndryshojnë nga një kohë në një kohë tjetër, nga një vend në një vend tjetër, por e përbashkëta e tyre mbetet gjithmonë një: shirku (t'i bësh shok Zotit). Allahu i Madhëruar thotë:* ***"(Dhe është e ndaluar) ta kërkoni fatin me short. Ky është gjynah ndaj Allahut."*** *(5:3) Dhe:* ***"Vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetave (për fall) janë vepra të ndyra nga shejtani."*** *(5:90)*

Shekulli XXI. "Ç'thonë yjet për ju sot?" Horoskopi na jepka përgjigjen e kësaj pyetjeje në televizion, në radio, në gazeta etj. Nuk janë të paktë ata që besojnë, vërtet se Afërdita, Marsi etj. mund t'u tregokan të ardhmen, mund t'u tregokan çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë. Janë burra dhe gra, të rinj e të reja, mjekë e të sëmurë, mësues e nxënës, drejtues e vartës, të pasur dhe të varfër. Mjaft shpesh, të shohin sytë njerëz të ulur pranë arixheshkave, të cilat me një pagesë simbolike, u tregokan të ardhmen. Është fare e thjeshtë: mjafton t'u tregosh pëllëmbën e dorës. Nuk janë të pakta edhe ato gra, që pasi shijojnë kafenë e ngrohtë, përmbysin filxhanët

dhe presin me padurim që njëra t'i marrë e t'u lexojë ... "të ardhmen". Herë pas here, po na dalin edhe "profetë", që me "mrekullitë" dhe "parashikimet" e tyre qesharake çorodisin e çorientojnë mendjet e njerëzve të paformuar.

Shpesh, kur hipën në ndonjë autobus ndërqytetor, qëllon që diku, në mes të rrugës, përpara a pranë një tyrbeje, teqeje a varri të ashtuquajtur të mirë, të thonë të ngrihesh e të rrish më këmbë. Madje, ndodh që autobusi të ndalojë plotësisht dhe njerëz, që nuk duken aspak anormalë, lënë pará në tyrbet, në varret, në teqetë a në vendet e ashtuquajtura të shenjta, duke shpresuar të kenë mbarësi në punë, në udhëtim etj. Më të shumtën e rasteve, paratë i merr ai që ruan aty a një kushdo qoftë. Për çfarë? Ku dihet për çfarë!

Thonë se janë fjalë plakash, por ka jo vetëm plaka që u besojnë këtyre fjalëve. Mos bëni udhëtime të gjata! Është ditë tersi, është e martë. Po të doli një mace e zezë në rrugë, ndalo. Po more bukë me vete nga shtëpia dhe nuk e ha, mos e kthe, sepse të kthehet nusja. Numri 13, gjithmonë ters. T'u thye pasqyra, 7 vjet fatkeqësi ke prapa. T'u derdh kripa, prit fatin e keq.

Një letër e futur poshtë derës të thotë se, në qoftë se nuk e beson çfarë shkruhet në të dhe nuk bën njëzet kopje që t'i shpërndash, një fatkeqësi do të godasë (!). Një lule "e shenjtë", që duhet ujitur me çaj e që nuk duhet shikuar për një javë, na plotësoka çdo dëshirë.

Dikush niset për një punë me mosbesim, duke thënë me vete: "S'më ecën mua!" ose "Keq shkojnë punët e mia". "A thua ka njeri më fatkeq se unë?". Dikush e lidh mossuksesin me persona, me vende, me zëra shtazësh a shpendësh, me lëvizje sysh a me ndonjë fjalë etj.

Mund të vazhdonim të përmendnim shumë e shumë kotësi të tilla. Por le të kthehemi te fillimi dhe të pyesim: A mundet që një i vdekur, sado i mirë të ketë qenë, të të

sjellë mbarësi, kur i drejtohesh atij?! Kotësia e "ditëve të tersit", e shenjave "që sjellin fatkeqësi" etj. do të dukej edhe më e qartë, në qoftë se do t'i ktheheshim origjinës së tyre.[1]

Ç'thotë Islami për këto? Besime të tilla u ngjajnë atyre të idhujtarëve në kohën para Islamit. Ata e shihnin "të ardhmen" e tyre te falltarët. Për udhëtime, për punë të rëndësishme etj. linin të vendosnin shigjetat, zogjtë etj., në vend që të vendosnin ata vetë. Prandaj, jo më kot koha e tyre është quajtur "Koha e Padijes". Allahu i Madhëruar thotë **"(Dhe është e ndaluar) ta kërkoni fatin me short. Kjo është gjynah ndaj Allahut**". (Kur'ani, 5:3) Dhe: "**Vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetave** (për fall) **janë vepra të ndyra nga shejtani".** (5:90) Profeti (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ka ndaluar të ndiqen idhujtarët dhe zakonet e tyre. Në një hadith, ai thotë: "*Kush përpiqet t'i ngjajë një populli, është prej tyre*".[2]

Besime të tilla, megjithëse duken të vogla, janë, në të vërtetë shkatërruesit e themelit të besimit të një myslimani, shkatërruesit e besimit në një Zot. Besime të tilla mund të ndryshojnë nga një kohë në një kohë tjetër, nga një vend në një vend tjetër, por emëruesi i tyre i përbashkët mbetet gjithmonë një: shirku (t'i bësh Zotit shok). Prandaj, p.sh., për shenjat e fatit dhe për parandjenjën e keqe Profeti (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë tri herë se besimi në to është shirk.[3]

Gjithçka, e mira dhe e keqja janë të paracaktuara nga Allahu. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: "**Nuk ndodh asnjë fatkeqësi, as në Tokë dhe as në trupin tuaj, që të mos jetë shënuar në Libër** (Leuhul Mahfudh)".

1. Për më gjerë shih te *Bazat e teuhidit.*
2. Hadithi është kumtuar nga imam Ahmedi dhe është vërtetësuar nga Nasrudin Al Albani në "Iruaul Galil".
3. Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

(Kur'ani, 57:22) Vetëm Allahu e di të ardhmen. Për këtë Allahu thotë: "Thuaj: "**Askush, përveç Allahut, as në qiej, as në Tokë nuk e di të fshehtën**". (Kur'ani, 27:65). Dhe: "**Është Ai që e di të fshehtën, por, fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt**" (72:26). Dhe: "**Askush nuk e di ç'do të ndodhë të nesërmen**". (Kur'ani, 31:34) Allahu nuk ia ka treguar këtë të fshehtë as Profetit të Tij. Ai i drejtohet të Dërguarit të Vet (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kështu: "**Thuaj**: "**Unë nuk ju them juve se kam depot e Allahut** (e t'ju sjell mrekulli), **as nuk mëtoj se e di të fshehtën, as nuk ju them se jam melek** (engjëll)". (Kur'ani, 6:50) Atëherë, ç'janë këta të ashtuquajtur parashikues të së ardhmes?! Ja si i drejtohet Allahu i Madhëruar Profetit të Tij (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)" "**Thuaju (o, Muhamed): "A mos keni ndonjë dije, që ta nxirrni para Nesh? Ju, vërtet mbështeteni vetëm në hamendje: ju, vërtet vetëm gënjeni**". (Kur'ani,, 6:148) Allahu i Madhëruar thotë, gjithashtu: "**Ata, që ju i adhuroni përveç Allahut, nuk janë gjë tjetër, veçse emra, që i pagëzuat ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për to; vendimi nuk i takon askujt, përveç Allahut e Ai urdhëroi që të mos adhuroni askënd tjetër e asgjë tjetër përveç Atij; por shumica e njerëzve nuk e dinë".** (Kur'ani, 12:40) Vërtet, "shumica e njerëzve nuk e dinë"; nuk e dinë që kështu e bëjnë veten rob të krijesave, që janë si ata, ndoshta edhe më të dobët se ata. Të ashtuquajturat parashikime që dëgjon njeriu në të tilla raste fusin frikë, hamendje, dyshime, zhgënjime e pesimizëm në jetën e tij. Truri i njeriut fillon të besojë lehtë çdo fantazi që i thuhet, madje edhe fantazinë që e ka pjellë vetë mendja e tij, mjafton që kjo të mendohet se është në dobi të së ardhmes së tij. Shpresat e tij fillojnë të varen plotësisht nga gjëra të paqena. Edhe sikur nga një

cep i largët i nënndërgjegjes t'i thuhej se ajo që beson nuk mund të jetë e vërtetë, ai do të vazhdojë të shpresojë edhe më verbërisht. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "**Ne do të mbjellim frikën në zemrën e atyre që nuk besuan sepse ata trillojnë dhe i bëjnë shokë Allahut zota të tjerë pa asnjë fakt. Prandaj vendi i tyre do të jetë Xhehenemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve!**" (3:151)

Idhujtarët kërkonin ndërmjetës për t'u afruar tek Allahu i Madhëruar, siç thotë Allahu në Kur'an: "**Ata** (idhujtarët) **adhuronin në vend të Allahut atë që nuk u bënte atyre as keq e as mirë dhe thoshin**: "**Ata janë ndërmjetësit tanë tek Allahu**"." (Kur'ani, 10:18) Atëherë, Allahu u tha atyre: "**Lutjuni atyre, të cilët i morët për zota, përveç Allahut. Ata nuk kanë as grimcën më të vogël, as në qiej dhe as në Tokë".** (Kur'ani, 34:22, 23) Dhe: "**Lutjuni atyre, të cilët i menduat (për zota), përveç Atij. Ata nuk mund ta heqin prej jush të keqen**". (Kur'ani, 17:56)

Atëherë, ku duhet ta kërkojmë ndërmjetësimin? Vetëm tek Allahu i Madhëruar, duke i besuar vetëm Atij, duke besuar në të Dërguarin e Tij, duke iu lutur vetëm Allahut. T'i lutemi Allahut vetë ne, sepse Allahu i Madhëruar është Ai që u përgjigjet lutjeve tona, sepse është vetëm Allahu që e sjell të mirën, sepse është vetëm Allahu, që mund ta largojë të keqen dhe të sjellë të mirën. Në qoftë se e kaluara është e dhembshme dhe e ardhmja e errët, drejtoju Allahut! Kur të gjithë të kthejnë shpinën, drejtoju Allahut! Allahu i Madhëruar thotë: "**Zoti juaj ka thënë: "Lutmuni Mua, që t'ju përgjigjem. Ata që i shmangen adhurimit Tim nga mendjemadhësia, do të hyjnë të poshtëruar në Xhehenem".** (Kur'ani, 40:60) Dhe: **"Zoti që më krijoi, më udhëzon. Dhe Ai më ushqen dhe më jep të pi. Dhe, kur të sëmurem, Ai më shëron. Ai më bën të vdes dhe pastaj më ngjall. Tek Ai kam shpresë**

**se do të m'i falë gjynahet Ditën e Gjykimit. Zoti im, më dhuro urtësi dhe më bashko me të mirët!"** (26:80) Dhe: **"Thuaj: "Kush ju shpëton prej errësirave të tokës e të detit kur ju i luteni Atij (Allahut) me përvuajtësi ...?"** (6:63) Dhe: **"Thuaj: "Allahu ju shpëton nga këto dhe nga çdo brengosje tjetër. Megjithëkëtë, ju i bëni shok Atij".** (6:64)

Vërtet, Allahu e ka lejuar Profetin (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të jetë ndërmjetësuesi i atyre që besuan, por vetëm Ditën e Gjykimit ose me lutje nga ai, kur ai ishte gjallë. Kjo do të thotë që ne t'i lutemi Allahut të na e bëjë mundësi ndërmjetësimin e Profetit (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) Ditën e Gjykimit (insha Allah!). Por, mënyra më e mirë që ta presim dhe ta meritojmë ndërmjetësimin e Profetit (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) atë Ditë është të besojmë çiltërsisht në Allahun, t'u bindemi urdhrave të Allahut dhe porosive të Profetit (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Por, a mundet një njeri i mirë, i gjallë të lutet për ty? Natyrisht, ai mund të bëjë lutje për ty; por Islami nuk lejon në asnjë mënyrë t'u drejtohemi a t'u lutemi varreve, tyrbeve, njerëzve të ashtuquajtur të mirë etj., të ndërmjetësojnë për ne tek Allahu. Fjala e fundit e Profetit (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), para se të vdiste, ishte: *"I mallkoftë Allahu ata njerëz, që i bëjnë varret e të dërguarve faltore!"*[4] T'u drejtohesh e t'u lutesh varreve, tyrbeve, njerëzve të ashtuquajtur të mirë të vdekur etj., do të thotë të bësh shirk, t'i bësh shok Allahut të Madhëruar. E, ky është gjynahu më i madh, të cilin Allahu nuk e fal. Për këtë Allahu thotë: **"Allahu nuk fal që t'i bëhet shok Atij".** (Kur'ani, 4:48) I lutemi Allahut të Madhëruar të na bëjë nga ata që nuk i bëjnë shok Atij.

4. Nga "Sahihul Buhari".

**Abduldaem Al - Kahiil**

# Mashkulli nuk është si femra: Një vizion i ri shkencor

## Abstrakt

*Kohët e fundit, shkencëtarët kanë argumentuar se të gjitha teoritë dhe kërkimet e mëparshme janë të gabuara, kur thonë se truri i femrës është njëlloj si truri i mashkullit. Ky përfundim është arritur duke përdorur teknologjinë e rezonancës magnetike. Një studim i ri nga Universiteti i Albertës tregon se meshkujt dhe femrat përdorin pjesë të ndryshme të trurit të tyre kur kryejnë detyra të njëjta. Te meshkujt, shumë zona të trurit që komunikojnë me amigdalën, kanë të bëjnë me mjedisin e jashtëm dhe i përgjigjen mjedisit të jashtëm. Për shembull, korja pamore është përgjegjëse për shikimin, kurse striatumi bashkërendon veprimet lëvizore. Përkundrazi, te femrat, shumë zona që lidhen me gjysmësferën e majtë, amigdala kontrollon aspekte të mjedisit brenda trupit. Për shembull, edhe korja ishullore, edhe hipotalami, marrin informacion të fuqishëm nga ndijuesit brenda trupit.*

*Atë që thonë shkencëtarët, na e ka thënë Allahu i Gjithëfuqishëm 1400 vjet më parë në gojën e profetit Musa: "**Zoti ynë është Ai i Cili i ka dhënë çdo gjëje (të Krijuar) trajtën dhe natyrën e saj dhe pastaj i dha (asaj) udhëheqësinë**". (Surja "Ta-Ha": 50)*



Ky është një skaner modern me rezonancë magnetike që u jep mundësi shkencëtarëve të rishqyrtojnë disa teori të mëparshme, njëra nga të cilat është teori e gabuar se truri i mashkullit dhe truri i femrës janë njëlloj.

Njëri nga ata shkencëtarët është Lorëns Samërs (Lawrence Summers), president i Universitetit të Harvardit, i cili thotë se dallimet e lindura në ndërtimin e trurit të mashkullit dhe trurit të femrës mund të jetë një faktor që ka të bëjë me mungesën relative të femrave në shkencë. Mendimi i tij rindezi një debat që zjeu për një shekull, qëkur disa shkencëtarë matën trurin e të dy sekseve dhe filluan ta përdornin zbulimin e tyre kryesor - truri i femrës ka prirje të jetë më i vogël - për të mbështetur pikëpamjen se femrat janë intelektualisht më poshtë se meshkujt.

## Meshkujt dhe femrat dallojnë në përdorimin e trurit kur kryejnë detyra të njëjta

Një studim i ri nga Universiteti i Albertës tregon se meshkujt dhe femrat përdorin pjesë të ndryshme të trurit të tyre kur kryejnë detyra të njëjta. Rezultatet e studimit janë pasqyruar në revistën

"Neuroimaging". Për studimin u morën vullnetarë. Atyre iu dhanë detyra memorizimi, detyra verbale, detyra pamore në hapësirë dhe detyra të thjeshta motorike (lëvizore). Ndërkohë, veprimtaria e trurit të tyre monitorohej me teknologjinë funksionale të rezonancës magnetike (fMR).

**Kur edhe mashkulli dhe femra janë duke kryer detyrë të njëjtë, zona të ndryshme reagojnë në veprimtarinë e trurit të tyre.**

"Rezultatet ishin shumë të dukshme për ne", - tha Emili Bell (Emily Bell), doktor në psikiatri në Universitetin e Albertës dhe autori kryesor i kumtesës "aktivizim i ndryshëm i trurit të meshkujve dhe të femrave për detyra të njëjta dhe aktivizim i njëjtë i trurit për detyra të ndryshme". Dr. Piter Silverstëun (Peter Silverstone), psikiatër në Universitetin e Albertës dhe autor i studimit thotë: "Njihet gjerësisht se ka dallime ndërmjet meshkujve dhe femrave. Aktivizimi i zonave të ndryshme të trurit te meshkujt dhe te femrat si përgjigje për të njëjtën detyrë ka ndërlikime të mëdha potenciale për shumë situata të ndryshme klinike". Silverstëuni përmend gjendjen psikike të depresionit të madh si një shembull i dallimeve psikologjike ndërmjet meshkujve dhe femrave: kjo gjendje depresioni është dy herë më shumë te femrat se te meshkujt. Ai shton se ka shumë gjendje të tjera psikike kur raporti mashkull - femër nuk është i barabartë ose kur meshkujt dhe femrat shfaqin simptoma të ndryshme dhe profile të ndryshme për të njëjtën gjendje. "Ne mund të vazhdojmë, - thotë Silvestëun, - se mund të gjejmë gjithnjë e më shumë dallime në aktivizimin e trurit të mashkullit dhe të femrës".

## Edhe kur nuk është në punë, truri i mashkullit ka ndryshime në funksionim nga truri i femrës

Lari Kehill (Larry Cahill), profesor i asociuar i neurobiologjisë dhe sjelljes, dhe Liza Killpetrik (Lisa Kilpatrick), ish-doktor i shkencave kanë zbuluar se amigdala, një strukturë në trajtë bajameje në të dyja anët e trurit, funksionon krejt ndryshe te meshkujt dhe te femrat ndërkohë që personat pushojnë.

Te meshkujt, amigdala e djathtë është më aktive dhe demostron më shumë lidhje me zona të tjera të trurit, madje edhe kur nuk ka asnjë nxitje të jashtme. Përkundrazi, te femrat, amigdala e majtë është më e lidhur me zona të tjera të trurit. Përveç kësaj, zonat e trurit me të cilat amigdala komunikon, kur personi pushon, janë të ndryshme te meshkujt dhe te femrat. Kështu, këta shkencëtarë besojnë se zbulimi mund të ishte një çelës për të përcaktuar përse ka dallime gjinore në çrregullime të caktuara psikike dhe si të trajtohen ato.

Kehill thotë: "Këto zbulime janë intriguese sepse sugjerojnë se cili mund të ishte dallimi themelor në mënyrën sesi funksionon truri te meshkujt dhe te femrat". "Nëse, madje edhe në gjendje pushimi, - shton ai, - truri paraqet të tilla dallime ndërmjet sekseve, atëherë, mund të kishte ndërlikime me pasoja të shumta për studimin tonë për çregullime të caktuara psikike dhe mjekësore". Për këtë studim, studiuesit përdorën skaner me tomografi me emetim positronesh (TEP) për të analizuar trurin e 72 të rriturve të shëndetshëm, djathtakë (36 meshkuj dhe 36 femra). Personave u tha të rrinin të qetë dhe me sy mbyllur, ndërkohë që skanoheshin. Kur u studiuan skanimet më pas, studiuesit zbuluan se jo vetëm kishte dallim ndërmjet meshkujve dhe femrave në lidhje me hemisferën ku amigdala ishte më aktive, por edhe zonat

e trurit ku amigdala "fliste me to" ishin, gjithashtu, krejt të ndryshme. Te meshkujt, amigdala e hemisferës së djathtë tregonte më shumë lidhje me zona të trurit, të tilla si korja pamore dhe striatumi. Përkundrazi, amigdala e majtë te femrat ishte më e lidhur me zona të tilla, si korja ishullore dhe hipotalami.

1. Korja paraballore
2. Zona e Brokut
3. Korja paralëvizore
4. Korja lëvizore
5. Korja e parësore trupore ndijimore
6. Vrigulli muror
7. Zona e shijimit
8. Zona e Uernikut
9. Gjysmësfera e majtë trunore
10. Arterie e majtë e trurit të mesëm
11. Korja dëgjimore parësore
12. Korja pamore parësore
13. Rrezatimi optik
14. Truri i vogël
15. Këmbëza e trurit



Truri i njeriut është pjesa kryesore e trupit që kontrollon veprimtarinë e trupit. Ai kontrollon mendimet, kujtesën, të folurin dhe lëvizjen. Ai rregullon funksionin e shumë organeve. Kjo lëndë e butë ju lejon të mendoni, të ecni, të flisni, të mësoni, të bëni shokë, të keni emocione dhe të dini çfarë do të thotë të jetosh. I Madhëruar qoftë Allahu!

Shkencëtarët mendojnë se kjo gjetje ka çuar në një zbulim të paparashikuar: Te meshkujt, shumë zona të trurit që komunikojnë me amigdalën, kanë të bëjnë me mjedisin e jashtëm dhe i përgjigjen mjedisit të jashtëm. Për shembull, korja pamore është përgjegjëse për shikimin, kurse striatumi bashkërendon veprimet lëvizore. Përkundrazi, te femrat, shumë zona që lidhen me gjysmësferën e majtë, amigdala kontrollon aspekte të mjedisit brenda trupit. Për shembull, edhe korja ishullore, edhe hipotalami, marrin informacion të fuqishëm nga ndijuesit brenda trupit.

Kahili thotë: "Gjatë jetës, femrave u duhet të kenë të bëjnë me një numër trysnish të brendshme, të tillë si lindja e fëmijës, që meshkujt nuk i kanë. Ajo që të mahnit, - shton ai, - është se truri është në harmoni me këto trysni të ndryshme".

Ajo që thonë dr. Kehilli dhe shkencëtarë të tjerë, na e ka thënë Allahu i Gjithfuqishëm 1400 vjet më parë në gojën e profetit Musa: ***"Zoti ynë është Ai i Cili i ka dhënë çdo gjëje (të Krijuar) trajtën dhe natyrën e saj dhe pastaj i dha (asaj) udhëheqësinë"***. (Surja "Ta-Ha": 50) Kjo do të thotë se Allahu i Gjithëfuqishëm, Krijuesi i të gjitha krijesave i dha çdo krijese aftësitë e duhura për ta kryer detyrën e caktuar ashtu siç duhet. I Madhëruar qoftë Allahu!

## Dhjetë dallimet kryesore ndërmjet trurit të meshkujve dhe trurit të femrave

Specialistët kanë idendifikuar dhjetë dallime ndërmjet trurit të meshkujve dhe trurit të femrave:

**1. Marrëdhëniet njerëzore:**

Femrat priren të komunikojnë në mënyrë më frytdhënëse se meshkujt, duke u përqendruar te gjetja e zgjidhjes që është në të mirë të grupit duke përdorur tonin, emocionin, dhe empatinë, kurse meshkujt priren më shumë drejt kryerjes së detyrës, të flasin më pak dhe të jenë më të veçuar.

**2. Truri i majtë te meshkujt, të dyja gjysmësferat te femrat:**

Meshkujt priren ta përpunojnë mendimin më mirë në gjysmësferën e majtë të trurit, ndërsa femrat priren ta përpunojnë mendimin po aq mirë sa meshkujt, por ndërmjet dy gjysmësferave. Ky dallim shpjegon përse meshkujt janë përgjithësisht më të të fuqishëm në veprimtaritë e trurit të majtë dhe i qasen zgjidhjes së një problemi nga pikëpamja e perspektivës së detyrës, ndërsa femrat zakonisht i zgjidhin problemet në mënyrë më krijuese dhe janë më të vetëdijshme për ndjenjat e tyre kur komunikojnë.

**3. Aftësitë matematikore:**

Një zonë e trurit, e quajtur lobi inferior parietal është zakonisht dukshëm më i madh te meshkujt, sesa te femrat veçanërisht në anën e majtë. Mendohet se kjo pjesë e trurit kontrollon aftësinë mendore matematikore dhe ndoshta me këtë shpjegohet përse meshkujt janë shpesh më lart se femrat në kryerjen e detyrave matematikore.

**4. Reagimi ndaj stresit:**

Meshkujt u përgjigjen situatave të stresit me metodat "lufto ose ik", ndërsa femrat duket se u qasen këtyre situatave me strategjinë "kujdesu dhe miqësohu".

**5. Gjuha:**

Dy pjesë të trurit përgjegjëse për gjuhën, u panë se ishin më të mëdha te femrat se te meshkujt, çka është një arsye përse femrat shquhen zakonisht në lëndët gjuhësore dhe në çështje që lidhen me gjuhën. Meshkujt e përpunojnë gjuhën në gjysmësferën e tyre dominuese, kurse femrat e përpunojnë gjuhën në të dyja gjysmësferat.

**6. Emocionet:**

Femrat kanë zakonisht një sistem limbik[1*] të thellë më të madh se meshkujt, çka u jep mundësi atyre të kenë më shumë ndjenja dhe t'i shprehin më mirë ato. Kjo i bën ato të krijojnë lidhje me të tjerët. Meqë e kanë këtë aftësi për të krijuar lidhje me të tjerët, femrat shërbejnë si kujdestare për fëmijën.

**7. Madhësia e trurit:**

Zakonisht, truri i meshkujve është 11 - 12 % më i madh se truri i femrave. Ky dallim në madhësi nuk ka të bëjë absolutisht aspak me inteligjencën; ai është thjesht dallim nga pikëpamja fizike ndërmjet meshkujve dhe femrave. Meshkujve u nevojiten më shumë neurone për të kontrolluar masën e tyre më të madhe muskulare dhe trupin e tyre më të madh. Për këtë arsye, përgjithësisht e kanë trurin më të madh.

1. Pesha e trurit
2. I sapolinduri
3. Mashkulli

1. Sistemi limbik është ajo pjesë e trurit që ka të bëjë me emocionet themelore dhe me veprimet instinktive. (*shënim i përkthyesit*)

4. Femra
5. Pesha e trurit / Pesha e trupit
6. I sapolinduri
7. Mosha




Figura e sipërme ilustron ndryshmin në peshën e trurit gjatë jetës së mashkullit dhe të femrës, nga lindja deri në moshën 86 vjeç.

Figura e poshtme ilustron përqindjen e peshës së trurit në krahasim me peshën e trupit gjatë së njëjtës periudhë.

**8. Dhembja:**

Meshkujt dhe femrat e ndiejnë dhembjen në mënyra të ndryshme. Sipas studimeve, femrat kërkojnë më shumë morfinë sesa meshkujt për ta pakësuar të njëjtën dhembje. Femrat janë, gjithashtu, më të priruara

për të rënkuar kur kanë dhembje dhe për të kërkuar mjekim sesa meshkujt. Zona e trurit që aktivizohet gjatë dhembjes është amigdala. Studiuesit kanë zbuluar se te meshkujt aktivizohet amigdala e djathtë, kurse te femrat aktivizohet amigdala e majtë. Amigdala e djathtë ka më shumë lidhje me zonat e trurit që kontrollojnë funksionet e jashtme, ndërsa amigdala e majtë ka më shumë lidhje me funksionet e brendshme. Ky dallim shpjegon ndoshta përse femrat e ndiejnë dhembjen më fort sesa meshkujt .

## 9. Aftësia hapësinore:

Meshkujt zakonisht kanë kanë aftësi hapësinore më të fuqishme, ose janë të aftë për të paraqitur forma dhe dinamika të tyre ; ndërsa femrat zakonisht mundohen ta bëjnë këtë. Specialistët e mjekësisë kanë zbuluar se femrat e kanë më të trashë zonën parietale të trurit , e cila e pengon aftësinë mendore për të rrotulluar objekte - një aspekt ky i aftësisë hapësinore. Studimet kanë treguar se foshnjat 5 - muajshe e kanë këtë aftësi, duke mohuar idenë se këto aftësi fuqizohen nga ndikimet mjedisore.

## 10. Ndjeshmëria e çrregullimeve:

Meqë meshkujt dhe femrat përdorin dy gjysmësferat e trurit në mënyra të ndryshme, ka çrregullime të cilat ndihen në mënyra të ndryshme te meshkujt dhe te femrat. Meshkujt janë të prirur më shumë për të pasur disleksi[2**] ose probleme të tjera gjuhësore. Kur kanë disleksi femrat, ato janë më të prirura për ta kompensuar atë.

2. Disleksia është çrregullim që shfaqet me vështirësi të madhe në lexim dhe shkrim. (*shënim i përkthyesit*)

## Meshkujt dhe femrat nuk janë njëlloj sipas Kur'anit dhe Synetit

I Madhëruar qoftë Allahu i Gjithëfuqishëm që na i ka thënë këto dallime në mënyrë koncize 1400 vjet më parë: *"**Dhe mashkulli nuk është si femra**".*{Surja "Al-Imran": 36} Këtu, na duhet të pohojmë se këto dallime nuk kanë të bëjnë me burrin dhe gruan si njerëz sepse edhe burri edhe gruaja kanë detyra për të kryer sipas aftësive të tyre.

Le të kujtojmë ajetin e shenjtë, kur Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: *"**Burrat janë mbrojtës dhe përgjegjës për gratë sepse Allahu e ka bërë njërin prej tyre të shquhet nga tjetri**".*{Surja "En-Nisa": 34} Por, i Gjithëfuqishmi u ka dhënë grave një epërsi shumë të madhe ndaj burrave sepse Ai e ka urdhëruar njeriun të jetë i bindur dhe i sjellshëm me prindërit e tij, sidomos me nënën. I Gjithëfuqishmi thotë: *"**Dhe, Ne e kemi urdhëruar njeriun të jetë i bindur dhe i sjellshëm me prindërit, sepse nëna e tij me mundim e mbart dhe me mundim e lind**".* {Surja "Al-Ahkaf": 15}

Edhe Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i këshillon burrat të kujdesen për gratë kur thotë: "*Allahu i Gjithëfuqishëm ju porosit të kujdeseni për nënat tuaja, pastaj të kujdeseni për baballarët tuaj dhe pastaj për të afërmit tuaj*". (Treguar nga Al-Buhari) Në një hadith tjetër tregohet se një ditë, një burrë e pyeti Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "*Cilin duhet të dua më shumë, nënën apo babanë? Profeti tha: Nënën. Burri e pyeti përsëri: Po, pastaj? Profeti tha: Nënën. Burri e pyeti përsëri: Po, pastaj? Profeti tha: Nënën. Burri e pyeti përsëri: Po, pastaj? Profeti tha: Babanë*". {Treguar nga Ebi-Hurejre}

Përktheu: **Bledar Shehu**

**Harun Jahja**

# Rruga që bën ushqimi në trupin tonë


## Abstrakt

*Rruga që ushqimit i duhet të bëjë në mënyrë që të tretet është 10 metra. Kjo rrugë është afërsisht 6-7 herë më e madhe se gjatësia mesatare e trupit të njeriut. Si ka mundësi që një kanal i tillë kaq i gjatë të jetë vendosur në trupin e njeriut? Përgjigjja për këtë pyetje tregon edhe një herë tjetër që ekziston një projektim i veçantë në krijimin e trupave tanë.*

*Tretja fillon nga goja. Karbohidratet që gjenden në ushqimet që ju hani, copëtohen së pari në copa më të vogla nga pështyma që është në gojën tuaj. Në stomak ndodh një tjetër gjendje e mrekullueshme ekuilibri. Tretja e ushqimit në të kryhet nga një lëng shumë i fortë. Ky lëng është acidi klorhidrik. Falë acidit të fortë që gjendet në stomak ushqimet, të cilat janë në copa të mëdha, kur mbërrijnë në stomak, zbërthehen në pjesëza më të vogla, në mënyrë që të përdoren nga trupi. Por si ka mundësi që ky acid nuk e shkatërron vetë stomakun, i cili është mish? Këtu, shpaloset edhe një herë tjetër përsosuria në Krijimin e Zotit tonë. Allahu, i Cili ka krijuar çdo gjë në mënyrë të përkryer, ka projektuar një mburojë në stomak, në mënyrë të tillë që ai të mos gërryhet.*


Ne e sigurojmë energjinë e nevojshme për nevojat trupore nga ushqimet dhe pijet e ndryshme. Megjithatë, çdo ushqim që ne hamë, fillimisht ka nevojë të tretet para se të jetë i gatshëm të përdoret nga trupi ynë. Pasi këto us-

hqime janë tretur, ato përdoren nga qelizat e trupit tonë. Sheqeri në një banane a në një mollë siguron karburantin për qelizat tona dhe rrit energjinë; proteinat te mishi janë thelbësore për rritjen e numrit të qelizave. Tani, mundohuni të ktheheni prapa në kohë, në foshnjërinë tuaj.

Kur lindët, ju ishit afërsisht 2-3 kilogramë. Pesha juaj rritet në 30-35 kilogramë kur ju jeni 10 vjeç; 40-50 kilogramë kur arrini moshën 15 vjeç dhe 50-60 kilogramë kur arrini moshën 20-25 vjeç. Arsyeja për këtë diferencë kaq të madhe është fakti që substancat ushqimore që ju konsumoni, i shtohen trupit tuaj me kalimin e kohës. Disa nga ushqimet sigurojnë energjinë që ju nevojitet për të ngarë bicikletën, për të vrapuar dhe për të luajtur, ndërsa një pjesë e tyre i shtohen trupit tuaj dhe formojnë mishin dhe kockat tuaja. Materialet e tepërta shkarkohen jashtë trupit. Të gjitha këto procese kryhen në sistemin tuaj të tretjes. Gjëndrat dhe organe të tilla, si stomaku, zorrët dhe pankreasi kanë rolin e tyre në procesin e tretjes.

Funksionimi i sistemit të tretjes është i ngjashëm me funksionimin e një rafinerie nafte. Nafta e papastër që vjen te rafineria si lëndë e papërpunuar, përpunohet nga makineri të posaçme dhe rafinohet në mënyrë të tillë që të jetë e përdorshme. Ushqimet që ne hamë në fazën e parë janë të papërpunuara; më pas ato përpunohen në stomak që të përdoren nga trupi. Pasi të jenë tretur në stomak dhe në zorrë, ushqimet bëhen gati për t'u përdorur si ushqim për qelizat dhe transportohen në vendet e përshtatshme të trupit nëpërmjet enëve të gjakut.

Në një rafineri nafte nga përpunimi i një substance fillestare dalin një varg nënproduktesh, për shembull benzina, e cila përdoret si karburant për automjetet, ose goma që përdoret si shuall për këpucët tuaja. Në mënyrë të ngjashme, lëndët ushqyese që gjenden në ushqimet që ju hani, ndahen në yndyrna, sheqerna dhe karbohidrate

në stomakun tuaj. Por duhet të keni parasysh se ajo çfarë ndodh në stomakun tuaj pasi keni ngrënë një sanduiç të shijshëm, është ende shumë më komplekse se ajo çfarë ndodh në një rafineri. Por këto veprime, të cilat ne do t'i diskutojmë më poshtë nuk marrin pjesë në ndonjë fabrikë gjigande, por në një zonë shumë të vogël brenda trupit tuaj. Rruga që ushqimit i duhet të bëjë në mënyrë që të tretet është 10 metra. Kjo rrugë është afërsisht 6-7 herë më e madhe se gjatësia mesatare e trupit të njeriut. Si ka mundësi që një kanal i tillë kaq i gjatë të jetë vendosur në trupin e njeriut? Përgjigjja për këtë pyetje tregon edhe një herë tjetër që ekziston një projektim i veçantë në krijimin e trupave tanë.

Meqenëse aparati i tretjes është mbledhur kutullaç, pavarësisht nga gjatësia e tij, ai është në një zonë shumë të vogël. Kjo formë e veçantë është një projektim i përkryer i Zotit tonë, i Cili ka krijuar çdo gjë. Kjo veçori e sistemit të tretjes është vetëm njëra nga mrekullitë që Allahu ka krijuar në trupat tanë.

## A e dini përse dhëmbët tuaj kanë forma të ndryshme?

Arsyeja se përse dhëmbët kanë forma të ndryshme është se secili prej tyre ka detyra të ndryshme. Për shembull, dhëmbët tuaj të parë janë të mprehtë, kështu që ju mund kafshoni një mollë me lehtësi. Çfarë do të ndodhte sikur dhëmballët tuaja të ishin përpara? Ju nuk do të ishit në gjendje ta kafshonit mollën. Po ashtu, nëse dhëmbët tuaj të parë do të ndodheshin në pjesën e prapme të gojës, ju nuk do të ishit në gjëndje ta bluanit ushqimin që ju hani. Ashtu si çdo pjesë sado e vogël e trupit tuaj, edhe dhëmbët në gojën tuaj janë rregulluar nga Allahu në mënyrën më të përshtatshme dhe më të favorshme për ju.

## Në pjesën e prapme të gjuhës jetojnë bakterie të dobishme

Bakteriet në përgjithësi njihen si shkaktare sëmundjesh dhe për të qenë të mbrojtur nga ndikimet e tyre të dëmshme, njerëzit duhet të jenë të kujdesshëm në punë të pastërtisë së trupit të tyre, ashtu edhe të mjedisit ku jetojnë. Por, megjithatë, jo shumë kohë më parë, shkencëtarët zbuluan ekzistencën e disa bakterieve të dobishme në trupin e njeriut dhe në veçanti, në pjesën e prapme të gjuhës. Pra, ka edhe bakterie të dobishme në trupin tuaj. Detyra e bakterieve në fund të gjuhës është që të ngordhin mikrobet e dëmshme që ndodhen në stomakun tuaj. Por sigurisht që kjo nuk është detyrë e lehtë. Për këtë kërkohen një varg veprimesh. Para së gjithash, këto bakterie shndërrojnë nitratin që gjendet në perimet jeshile në nitrit. Megjithatë, procesi nuk ka mbaruar ende. Nitriti, në bashkëpunim me pështymën që sekretohet në gojë, ka efekt vrasës ndaj mikrobeve. Me fjalë të tjera, bakteriet që ndodhen në fundin e gjuhës ndihmojnë prodhimin e një substance mikrobvrasëse. Siç e dini, mikrobet shkaktojnë sëmundje të ndryshme. Falë bakterieve të dobishme që prodhojnë një substancë mikrobvrasëse, ju jeni të mbrojtur nga shumë sëmundje. Këto bakterie të dobishme janë një nga shfaqjet e mëshirës së Zotit tonë, i Cili i krijoi trupat tanë në mënyrën më të përkryer. Allahu na ka dhënë shumë të mira dhe dhurata. Ne nuk i numërojmë dot këto të mira e dhurata. Në një ajet kur'anor thuhet: ***"Nëse do të mundoheshit t'i numëronit mirësitë e Allahut, ju kurrë nuk do të arrinit t'i numëronit ato. Allahu është i Mëshirshëm dhe Falës i Madh."*** (Sure "En Nahl", ajeti 18)

## SI E TRET STOMAKU USHQIMIN?

Tani le ta shohim më hollësisht procesin e tretjes. Trupat tanë kanë nevojë për energji. Ne tashmë e kemi shpjeguar që këtë energji e marrim nga ushqimi që hamë. Por ushqimi që kërkon trupi duhet të jetë i thjeshtë dhe i grimcuar në përmasa të tilla që të jetë në gjëndje të kalojë nëpër enët e gjakut. Përndryshe, ai nuk do të ketë mundësi të depërtojë në qeliza. Megjithatë, ushqimet që ne hamë janë në copa të mëdha. Kështu që na nevojitet një makineri që t'i mundësojë trupit tonë ta përdorë ushqimin që hamë. Në fakt, ne mund ta quajmë shkurt këtë një mulli, i cili në parim, copëton ushqimin që ne hamë në pjesëza më të vogla. Kjo makinë bluajtëse në trupin tuaj, quhet "sistemi i tretjes".

Ky sistem, si çdo makineri, përbëhet nga komponentë të ndryshëm. Në saje të funksionimit të përkryer të secilit prej këtyre komponentëve, ne mundemi ta tresim ushqimin. Por është thelbësore që komponentët e sistemit të tretjes të funksionojnë në harmoni dhe në mënyrë të plotë sepse përndryshe, prishet tërësisht sistemi. Le të sjellim një shembull për të ilustruar se përse të gjithë komponentët e sistemit duhet të jenë të plotë për funksionimin e duhur të tij. Një makinë lodër me komandim në distancë përbëhet nga pjesë të tilla, si rrotat, një pajisje kontrolli, motori, bateritë, ingranazhet, bobina elektrike, antena etj. Në mënyrë mjaft të ngjashme, sistemi i tretjes është i përbërë nga komponentë të ndryshëm. Këta komponentë përfshijnë dhëmbët, gojën, ezofagun, stomakun dhe zorrët. Tani, mendoni, a do të funksiononte një makinë e komanduar në distancë, nëse ajo nuk do të kishte antenë apo rrota? Sigurisht që jo. Makina mund të ecë vetëm nëse ajo i ka të gjitha pjesët e saj. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për sistemin e tretjes. Ekzistenca

e stomakut do të ishte e pakuptimtë nëse nuk do të kishte edhe një ezofag sepse ai që e transporton ushqimin për në stomak është ezofagu. Në të njëjtën mënyrë, zorrët nuk do të kishin ndonjë dobi, nëse nuk do të ekzistonte stomaku, për arsye se ushqimet që treten në stomak më pas kalojnë për në zorrë. Në zorrë ushqimit i jepet forma e duhur që të jetë i përshtatshëm për t'u transportuar në qelizat e trupit.

Kjo na tregon qartë që Zoti ynë, Krijuesi i çdo gjëje, ka krijuar për ne një sistem që është i përkryer nga çdo anë që ta marrim. Kjo tregon edhe një herë që nuk ka zot tjetër përveç Allahut: ***"Zoti juaj është vetëm Allahu e nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai ka përfshirë çdo gjë me diturinë i Tij."*** (Sure "Ta Ha", ajeti 98)

## MAKINA TRETËSE FILLON PUNËN...

Tretja fillon nga goja. Karbohidratet që gjenden në ushqimet që ju hani, copëtohen së pari në copa më të vogla nga pështyma që është në gojën tuaj. Që të zbërthehet plotësisht djathi së bashku me bukën që ju hëngrët, nevojitet një kohë më e gjatë. Lëndët ushqimore të copëtuara në gojë kalojnë përmes ezofagut dhe arrijnë në stomak. Në stomak ndodh një tjetër gjendje e mrekullueshme ekuilibri. Tretja e ushqimit në të kryhet nga një lëng shumë i fortë. Ky lëng është acidi klorhidrik. Siç e dini, acidet janë gërryese. Ato janë në gjendje të shpërbëjnë çfarëdolloj gjëje me të cilën ato bien në kontakt. Për shembull, ajo që nënat tuaja përdorin për të pastruar një prizë me vrima të bllokuara, është një lëndë më përmbajtje acide. Për të shkatërruar papastërtitë a mbeturinat që kanë bllokuar tubin e lajtores, janë lëndët acide. Falë acidit të fortë që gjendet në stomak ushqimet, të cilat janë në copa të mëdha, kur mbërrijnë në stomak, zbërthehen

në pjesëza më të vogla, në mënyrë që të përdoren nga trupi. Por ka edhe një pikë tjetër që duhet vënë re. Si ka mundësi që ky acid nuk e shkatërron vetë stomakun, i cili është mish? Acidet e stomakut e tretën mishin që hëngrët p.sh., për darkë dhe nuk e gërryen stomakun, i cili edhe ai është po ashtu një copë mishi. Si ka mundësi që kjo të jëtë kështu? Këtu, shpaloset edhe një herë tjetër përsosuria në Krijimin e Zotit tonë. Allahu, i Cili ka krijuar çdo gjë në mënyrë të përkryer, ka projektuar një mburojë në stomak, në mënyrë të tillë që ai të mos gërryhet. Këtë mburojë mund ta përshkruajmë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë: një lëng tjetër që quhet mukozë, sekretohet në stomak gjatë procesit të tretjes, në mënyrë që të pengojë acidin klorhidrik të shkatërrojë stomakun. Një shtresë e veçantë mukoze shërben si veshje e brendshme e stomakut dhe e mbron atë nga dëmtimi që mund të shkaktohet nga ky acid i fuqishëm. Në këtë mënyrë, stomaku nuk e tret veten e tij.

Vendndalimi tjetër përgjatë rrugëtimit të tretjes janë zorrët. Lëndët ushqimore zbërthehen në pjesë edhe më të vogla dhe bëhen kështu të gatshme për t'u përdorur nga trupi. Ajo çfarë është e dobishme nga këto lëndë ushqimore futet në sitemin e qarkullimit të gjakut, kurse mbetjet e panevojshme shkarkohen jashtë trupit nga sistemi i jashtëqitjes. Fazat nëpër të cilat ushqimi i ngrënë kalon në zorrë janë, gjithashtu, shumë të rëndësishme. Tretja vazhdon po ashtu si te stomaku, edhe në zorrë. Lëndët ushqimore zbërthehen në pjesëza edhe më të vogla. Ato tashmë janë aq të vogla, saqë mund të përthithen nga enët e gjakut që ndodhen në pjesën e brendshme të zorrëve dhe futen kështu në sistemin e qarkullimit të gjakut për t'u përcjellë në çdo pjesë të trupit.

Procesi i tretjes së ushqimit do të ishte shumë i vështirë, nëse ky mekanizëm nuk do të punonte në

mënyrë kaq të përsosur. Para së gjithash, nëse ne nuk do të kishim dhëmbë, nuk do të kishim mundësi ta përtypnim ushqimin në mënyrë të mjaftueshme dhe ai nuk do të kalonte poshtë përmes fytit. Por, edhe nëse do të kalonte, ai do ta dëmtonte seriozisht ezofagun. Nëse stomaku ynë nuk do ta treste ushqimin, çdo gjë që ne do të hanim, do të mbeste si një masë e madhe në stomak, e kjo do të ishte mjaft shqetësuese. Përveç kësaj, si rezultat i pamundësisë për të tretur ushqimin, trupat tanë nuk do të siguronin ushqimin për të cilin ata kanë nevojë. Një trup i paushqyer humbet forcat e tij me kalimin e kohës dhe qelizat e trupit fillojnë të vdesin. Por ne nuk përjetojmë gjëra të tilla, sepse Zoti ynë krijoi çdo detaj të trupit tonë në mënyrë të përkryer. Ky sistem i mrekullueshëm punon në mënyrë të përsosur dhe ne jemi pothuaj të pavetëdijshëm për një sistem të tillë. Kjo mrekulli në Krijim përshkruhet në ajetin e mëposhtëm: ***"Ai është Allahu – Krijuesi, Bërësi, Formësuesi. Atij i përkasin Emrat Më të Bukur. Çdo gjë në qiej dhe në Tokë e madhëron Atë. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti."*** (Sure "El-Hashr", ajeti 24)

## RRUGA E GJAKUT

Në gjithë trupin tonë ka një rrjet gjigand nervash. Ka edhe një rrjet tjetër t'mrekullueshëm në trupin tonë. Ky është i përbërë nga enët e gjakut. Këto rrjete janë enët e gjakut. Si rrjeti i nervave, ashtu edhe enët e gjakut, shtrihen gjatë gjithë trupit. Ato janë aq të gjata, saqë, nëse do të shtriheshin mbi një sipërfaqe të sheshtë, gjatësia e tyre do të arrinte rreth 100 000 kilometra.

Në fakt, nuk është fare e vështirë të kuptohet që enët e gjakut shtrihen gjatë gjithë trupit tonë. Do të mjaftonte një gërvishje e vogël në çdo pjesë të trupit dhe menjëherë do të fillonte të rridhte gjak. Kjo tregon se gjaku qarkul-

lon në gjithë trupit tonë. Për ne është jetësore që të kemi enë gjaku në çdo pikë, sado të vogël të trupit, për arsye se siç u përmend, ushqimi që kërkohet nga qelizat e trupit, transportohet përmes enëve të gjakut. Oksigjeni, për të cilin qelizat kanë nevojë për mirëfunksionimin e tyre, transportohet, gjithashtu në gjak përmes enëve të gjakut.

Transportimi i lëndëve ushqimore në enët e gjakut mund të krahasohet me transportin e mallrave me anije. Para se të transportohen, të gjitha mallrat vendosen në port. Mallrat duhet të paketohen dhe të vendosen në anije në mënyrën e duhur. Pasi çdo gjë është ngarkuar, anija del nga porti dhe nis lundrimin. Kur mbërrin në portin e destinuar, të gjitha mallrat shkarkohen dhe shpërndahen në vendet e duhura. Lëndët ushqimore në enët e gjakut transportohen në qeliza në mënyrë të ngjashme me anijen që transporton ngakesa përmes detit. Oksigjeni, yndyrnat dhe aminoacidet rrjedhin në gjak në paketa dhe shkarkohen te qelizat e destinuara. Ky rregull transportimi nuk prishet kurrë. Sasi të duhura substancash të kërkuara transportohen në qelizat e duhura pikërisht në kohën e duhur. Në të kundërt, psh., në qoftë se një qelizë do të kishte nevojë për oksigjen dhe do të merrte yndyrna në vend të tij, kjo do të shkaktonte vdekjen e qelizës. Edhe gabimi më i vogël në këtë sistem do të çonte në dëmtime serioze. Gabime të tilla nuk ndodhin kurrë, përveç se në raste të pazakonta, për arsye se asnjë nga këto sisteme nuk ekziston rastësisht. Allahu, Krijuesi e krijoi këtë sistem në mënyrë të përkryer për shërbimin tonë.

## TRANSPORTIMI I NGARKESAVE

Tashmë, është shpjeguar, se të gjitha llojet e substancave, për të cilat ka nevojë trupi ynë transportohen

për në organet e caktuara nëpërmjet gjakut. Në të njëjtën kohë, qelizat e gjakut mbledhin materialet e panevojshme, të tilla si dioksidi i karbonit dhe sigurohen që ato të nxirren jashtë trupit. Në njëfarë mënyre, gjaku sillet si një makine plehrambledhëse. Duke ndaluar në secilën prej 100 trilionë qelizave në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë ditës, ai u lë qelizave atë për të cilën kanë nevojë dhe në të njëjtën kohë, mbledh atë që nuk është e nevojshme.

Gjaku, i cili është thjesht një lëng, mund të kryejë në mënyrë të pagabueshme një detyrë që kërkon shumë vëmendje dhe përgjegjësi. Ai e njeh secilën nga substancat që transporton, arsyen për çfarë do të përdoret dhe ku duhet te dërgohet. Për shembull, ai (gjaku) nuk transporton gabimisht te një qelizë dioksidin e karbonit që ai e ka marrë nga një qelizë tjetër si produkt të padobishëm. Ai gjithmonë, i furnizon qelizat me oksigjen dhe largon prej tyre dioksidin e karbonit. Gjaku e kryen këtë detyrë pa gabime dhe pa lodhje, sepse ai është një pjesë e sistemit të përkryer që Allahu krijoi në trupin e njeriut. Të gjitha qelizat e gjakut i kryejnë këto detyra pa bërë asnjë gabim, pasi ato i janë nënshtruar në mënyrë të pakushtëzuar sistemit të krijuar nga Allahu.

## USHTARËT NË GJAK

Çdo ditë, trupat tanë luftojnë kundër shumë baktereve, viruseve dhe mikrobeve. Një pjesë prej tyre ndalohen të hyjnë në trup, ndërsa një pjesë arrin që të depërtojë. Por, në trupin tonë ekzistojnë qeliza të veçanta për mbrojtje, për të luftuar kundër tyre, që quhen qelizat imune. Këto qeliza, të cilat janë si ushtarë që luftojnë kundër armikut dhe që mbrojnë trupat tanë nga rreziqet, lëvizin në rrjedhën e gjakut. Sa herë që ndodh ndonjë sulm nga "armiku", ato mund të arrijnë lehtësisht në

pjesën në fjalë të trupit përmes enëve të gjakut dhe të luftojnë kundër "armikut". Qelizat imune nuk i kanë mësuar vetëvetiu misionet e tyre, por i kanë ditur ato që në momentin kur erdhën në ekzistencë. Ato fillojnë ta kryejnë detyrën e tyre dhe të ruajnë trupin që në çastin e lindjes. Ky është një detaj i përkryer në krijimin e Allahut. Zoti ynë u ka mësuar qelizave të tilla njohuri shumë të rëndësishme dhe i ka vënë ato në shërbimin tonë.

## KOMUNIKIMI

Gjaku shërben edhe si mjet komunikimi në trup. Në gjak ekzistojnë lajmëtarë, të cilët i transportojnë mesazhet nga një pjesë e trupi, në një tjetër. Lajmëtarët, të njohur si hormone, transportojnë mesazhe në organet e duhura njëlloj si një postier që shpërndan postën. Shumë procese të rëndësishme, që përfshijnë rritjen, djersitjen dhe kontrollin e nivelit të sheqerit në gjak etj. janë vetëm në saje të saktësisë së shpërndarjes së këtyre mesazheve.

## GJAKU QË SHËRON PLAGËT

Ju duhet ta keni vënë re, që kur ndodh ndonjë dëmtim i lehtë i lëkurës, gjaku që del prej saj, ndalon të rrjedhë vetvetiu pasi kalon pak kohë. Kjo, në të vërtetë, është disi provokuese për logjikën, sepse në kushte normale, një lëng që rrjedh nga një vrimë nuk mund të ndalojë vetvetiu. Për ta kuptuar më mirë këtë fakt, supozoni se keni një tullumbace të mbushur me ujë. Nëse bëni një vrimë të vogël me gjilpërë në tullumbace, uji do të rrjedhë. A do të ndalojë rrjedhja pas pak kohe, pa një ndërhyrje nga ana juaj? Sigurisht që jo. I gjithë uji do të vazhdojë të rrjedhë, derisa tullumbacja të boshatiset. Kjo ndodh me të gjitha lëngjet në hapësirat e mbyllura. Gjaku

lëviz përmes një rrjeti të mbyllur venash dhe fillon të dalë jashtë edhe në rastin e një prerjeje të lehtë. Megjithatë, për shëndetin tonë është mjaft e rëndësishme që ai të ndalojë së rrjedhuri. Ju mund të keni dëgjuar për njerëz që vdesin nga humbje të tepërta gjaku në aksidente ose operacione. Por, çfarë e ndalon rrjedhjen e gjakut vetëm pak kohë pasi një plagë fillon të rrjedhë gjak? Mpiksja. Mpiksja e gjakut është një nga sistemet automatike të sigurisë në trupat tanë. Disa substanca që gjenden në gjak ndalojnë rrjedhjen e tij dhe mbyllin plagën. Falë aftësisë së mpiksjes së gjakut, ndalohet rrjedhja e tepërt e tij. Disa qeliza në gjak lajmërohen për enën e dëmtuar dhe nisen menjëherë në këtë vend. Fillimisht, ato rreshtohen përreth plagës dhe pengojnë rrjedhjen e gjakut duke thurur një rrjetë. Kjo rrjetë ngurtësohet me kalimin e kohës dhe formon atë që ne e quajmë shenjë të plagës.

Tani le të mendojmë së bashku: A ka mundësi që këto veprime të planifikuara të veprojnë rastësisht? Si ka mundësi që disa qeliza gjaku të informohen për një dëmtim diku në enët e gjakut, të cilat janë si një botë gjigande në krahasim me përmasat e tyre? Përse luftojnë ato për të ndaluar rrjedhjen e gjakut? Nga e dinë ato që duhet ta mbyllin plagën, në mënyrë që të ndalojnë humbjet e gjakut? Kush i mësoi këto qeliza që ato duhet ta mbyllin plagën?

Nuk ka mundësi që qelizat t'i kenë mësuar të gjitha këto rastësisht. Madje, edhe qeniet njerëzore, të cilat zotërojnë inteligjencë, nëse i jepet e drejta, nuk mund të krijojnë një sistem të tillë kaq të detajuar dhe t'i mësojnë qelizat se çfarë duhet të bëjnë. Sigurisht, inteligjenca që kanë këto qeliza nuk u përket atyre. Është Allahu që i frymëzon ato dhe ato veprojnë sipas një plani të përkryer. Allahu na njofton ne për përsosurinë e krijimit të Tij si më poshtë: ***"Ai është që krijoi shtatë qiej në shtresa. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh asnjë të metë.***

***Prandaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje? Prandaj, herë pas here, drejto shikimin e shikimi do të kthehet tek ti i përulur dhe i molisur!"*** (Sure "El-Mulk", ajetet 3-4)

## GJAKU - NJË LËNG I MREKULLUESHËM I PAKONKURUESHËM PËR T'U RIPRODHUAR

Shkencëtarët kanë kryer shumë studime, në mënyrë që të arrijnë të prodhojnë një lëng të ngjashëm me gjakun. Megjithatë, duke dështuar në arritjen e një qëllimi të tillë, ata hoqën dorë nga përpjekja për të imituar gjakun dhe i përqendruan kërkimet e tyre në fusha të tjera.

Shkencëtarët nuk mund ta imitojnë gjakun për arsye se mostrat e gjakut të marra nga një enë gjaku mpiksen menjëherë dhe struktura e gjakut bëhet e papërshtatshme për ekzaminim. Por edhe ruajtja e mostrave në epruveta qelqi përsëri nuk funksionon, për arsye se qelizat e gjakut nuk mbijetojnë plotësisht (në epruveta). Si rrjedhim, shkencëtarëve u është dashur t'i veçonin qelizat e gjakut dhe t'i ekzaminonin ato në mënyrë individuale. Pa dyshim, është një nga shpjegimet më të paarsyeshme dhe jologjike në botë të pretendosh që një substancë e tillë perfekte, e cila edhe as nuk mund të imitohet me të gjithë informacionin e mbledhur nga njerëzimi për vite me radhë, të ketë ardhur në ekzistencë spontanisht dhe në mënyrë të rastësishme. Allahu e krijoi gjakun si një substancë të pakonkurueshme. Një qelizë gjaku në trupin e njeriut, e cila ka aftësi të mahnitshme është një nga manifestimet e zgjuarsisë së pakufishme të Allahut.

## ZEMRA-MOTORI I TRUPIT

A keni menduar ndonjëherë se sa litra gjak qarkullojnë lart e poshtë pa pushim në trupin tonë? Për të kryer një

lëvizje të vazhdueshme, çdo objekt ka nevojë për një motor. Makinat, aeroplanët, motoskafët, madje edhe makinat lodër me komandim në distancë lëvizin me ndihmën e një motori. Në mënyrë të ngjashme, edhe gjaku që qarkullon në trupin tonë ka nevojë gjithashtu për një motor. Motori që vë në lëvizje gjakun tonë ditë e natë, për muaj, madje për vite me radhë, është zemra jonë.

Vendosni gishtat te kyçi i dorës dhe prisni pak. Ju do të ndieni rrahjen e zemrës suaj. Zemra juaj bën 70 rrahje në minutë dhe gjatë gjithë jetës tuaj pompon afërsisht 152 milionë litra gjak. Kjo sasi e madhe gjaku është afërsisht e barabartë me sasinë e naftës që mbajnë 10 000 fuçi nafte. Këto të dhëna janë befasuese, apo jo? Tani supozoni që ju duhet të zbrazni një kovë me ujë dhe ta kaloni atë në një tjetër me anë të një kanaçeje, 70 herë në minutë. Në fund të kësaj detyre muskujt e krahut dhe dorës suaj do t'ju dhembnin dhe juve do t'ju duhej të pushonit. Megjithatë, zemra juaj e kryen këtë detyrë përgjatë gjithë jetës suaj dhe ajo nuk pushon kurrë ndonjëherë gjatë kësaj kohe.

## POMPA MË E PËRKRYER

Pompa e ndërtuar në mënyrën më të përsosur në botë tani po rreh në anën e majtë të gjoksit tuaj. Me projektimin e saj të mrekullueshëm dhe kontraktimet e saj te pandërprera, zemra juaj i bën komplet gjakut në trupin tuaj 1000 cikle të plota gjatë një dite.

Zemra është një pompë e përbërë nga mishi, e cila afërsisht është sa një grusht dore. Megjithatë, ajo është dukshëm motori më i fortë, më jetëgjatë dhe më efikas në botë përsa i përket kapacitetit të saj. Ne kemi shumë arsye për t'u shprehur kështu për fuqinë e zemrës në këtë mënyrë. Ajo që është më e rëndësishmja është se zemra përdor një energji shumë të madhe kur ajo rreh. Me en-

ergjinë që përdoret nga zemra, gjaku mund të ngrihet deri në 3 metra lartësi. Do të ishte e dobishme të jepnim një shembull për ta bërë më të lehtë për të kuptuar kapacitetin e zemrës. Gjatë një ore zemra mund të prodhojë një sasi energjie që është e mjaftueshme për të ngritur një makinë mesatare një metër nga toka.

## Pompa origjinale në zemër

Zemra, e cila është një organ muskular me përmasat e një grushti dore, përbëhet nga dy pjesë. Në secilën nga këto pjesë ka nga një pompë. Pompa e majtë, e cila është më e fortë, dërgon gjak të pasur me oksigjen në të gjitha pjesët e trupit. Pompa e djathtë është më e dobët se e para dhe dërgon gjak të varfër me oksigjen në mushkëri.

Transporti i gjakut nga zemra për në mushkëri përshkon një distanë të shkurtër prandaj edhe quhet "qarkullimi i vogël". Ndërsa i pari quhet "qarkullimi i madh". Secila nga gjysmat e zemrës ndahet më tej në dy seksione të tjera. Gjaku kalon nga njëri seksion tek tjetri përmes valvulave të zemrës. Këto pompa punojnë pa ndërprerë me një sasi të madhe energjie, falë së cilave gjaku qarkullon në trupin tonë 1,000 herë në ditë.

## Zemra mirëmban veten e saj

Makineritë kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme. Mund të jetë e nevojshme që disa pjesë të makinës të mirëmbahen, ose të zëvendësohen ato pjesë që janë konsumuar. Makineritë kanë nevojë të trajtohen me vaj pas një periudhe kohe pune, në mënyrë që të zvogëlohet kunsumimi i tyre për shkak të fërkimit.

Po ashtu si makineritë, edhe zemra, e cila punon vazhdimisht gjatë gjithë kohës, ka, gjithashtu nevojë për

mirëmbajtje. Megjithatë, ajo e kryen vetë mirëmbajtjen e saj, ajo vetëlubrifikohet.

Por si e kryen zemra vetëlubrifikimin? Përgjigjja e kësaj pyetjeje fshihet në krijimin e zemrës. Sipërfaqja e jashtme e zemrës mbulohet nga një qese që përbëhet nga dy membrana. Midis këtyre membranave ndodhet një lëng i yndyrshëm. Ky lëng vepron ngjashëm me vajin e motorit dhe e lehtëson punën e zemrës. Kjo strukturë vetëmbrojtëse e zemrës shpalos edhe njëherë se sa e përkryer dhe e plotë është mjeshtëria e Allahut në krijim.

# Argumente shkencore në Kur'an për mjekësinë[1]


## Abstrakt

*Ka shumë fakte shkencore, të cilat janë sekrete të shpallura* në Kur'an *që bota mjekësore dalëngadalë ka filluar t'i vlerësojë. Disa nga faktet që përmenden në këtë artikull janë: ndikimi pozitiv që ka këndimi a leximi i Kur'anit dhe përsëritja e fjalës* ***"Allah"****, si te njerëzit e sëmurë, ashtu edhe tek ata normalë; kënaqësia shpirtërore te ngjyra e gjelbër; mrekullitë shkencore mjekësore në faljen (namazin) e natës; sekretet e Kur'anit në psikologji.*


## Zbulimi i psikologut Vander Hoven rreth shqiptimit të fjalës *"Allah"*

Vander Hoven, një psikolog nga Holanda, shpalli zbulimin e tij të ri në lidhje me Profesori holandez e konfirmon zbulimin e tij me studime dhe kërkime në shumë pacientë për një periudhë kohe mbi trevjeçare. Disa prej pacientëve të tij nuk ishin myslimanë, të tjerë nuk flisnin arabisht, por u mësuan të shqiptonin fjalën *"Allah"* në mënyrë të qartë: Rezultati ishte fantastik, veçanërisht për ata që vuanin nga mërzitja dhe tensioni. E përditshmja arabe "El Uatan" shkruan se psikologu ka thënë: "*Myslimanët që mund ta këndojnë e lexojnë arabisht dhe rregullisht Kur'anin, e mbrojnë veten e tyre nga sëmundjet psikike. Psikologu zbuloi se shqiptimi i çdo shkronje të fjalës "Allah" ka një efekt të veçantë dhe të papërsëritshëm mbi organizmin.*"

1. Marrë nga www.psikologjiaislame.webnode.com

Shqiptimi i tingullit "A" bën kontrollin e sistemit të frymëmarrjes.

Shqiptimi i tingullit të dytë, "L e dyfishuar" në arabisht, me gjuhën që prek pjesën e sipërme të qiellzës, krijon një pauzë të shkurtër dhe pastaj, duke e përsëritur të njëjtën pauzë në mënyrë konstante, lehtëson procesin e frymëmarrjes. Shqiptimi i tingullit të fundit, "H" bën një lidhje midis mushkërive e zemrës dhe për rrjedhojë, ky kontakt bën kontrollimin e rrahjeve të zemrës.

Ajo që është më e habitshme në këtë studim është fakti se psikologu nuk është mysliman, por është i interesuar për shkencat islame dhe bën kërkime për ato që quhen "sekrete të Kur'anit të Shenjtë".

Allahu i Madhëruar thotë: ***"Ne do t'ua bëjmë atyre të mundur që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në vetet e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë."*** ("Fusilet", 53)

## Psikologjia e ngjyrës në Kur'an

Ngjyra e gjelbër dhe kënaqësia shpirtërore.

Fjala *"e gjelbër"* përmendet shumë në ajetet e Kur'anit, veçanërisht në ato që përshkruajnë gjendjen e banorëve të Xhenetit dhe kënaqësitë që i rrethojnë ata.

***"Ata rrinë të mbështetur në mbështetëse të gjelbra e shtroja të bukura."*** ("Er Rrahman', 76)

***"Ata veshin rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë e të trashë."*** ("El Kehf", 31)

Psikologët thonë: Ndikimi i ngjyrës te njeriu është shumë i madh. Janë kryer shumë eksperimente që bëjnë të qartë se ngjyra ndikon në reagimin apo vetëpërmbajtjen e njeriut dhe e bën atë të ndihet i gëzuar apo i trishtuar, të ketë të ftohtë apo vapë. Ngjyra ndikon edhe në personalitetin e njeriut dhe në këndvështrimin e tij për jetën.

Spitalet kanë filluar të thërrasin specialistët për t'u propozuar ngjyrën e mureve që ndihmon për shërimin e të sëmurëve e po kështu, ngjyrën e rrobave.

Eksperimentet dhe studimet psikologjike tregojnë se ngjyra e verdhë gjallëron sistemin nervor, ngjyra e kuqe e mbyllur qetëson nervat, ngjyra blu (e kaltër) e bën njeriun që të ndiejë të ftohtë, ngjyra e kuqe e bën njeriun të ndiejë të ngrohtë.

Shkencëtarët kanë arritur në përfundimin se ngjyra e vetme që sjell gëzim në shpirt dhe gjallëri në mendime dhe që ndez te njeriu shkëndijat e gëzimit dhe të dashurisë për jetën, është e gjelbra.

Eksperimenti më interesant që argumenton ndikimin e ngjyrës së gjelbër është ai që zhvilluan banorët e Londrës me urën "Black Fajar", që njihej si "ura e vetëvrasjeve", pasi pjesa më e madhe e rasteve të vetëvrasjeve ndodhnin mbi të.

Ndryshuan ngjyrën, nga ngjyrë pluhuri të errët në ngjyrë të gjelbër: numri i vetëvrasjeve ra menjëherë në një të tretën.

Ky është ndikimi i ngjyrës së gjelbër te njeriu. Vështro urtësinë e Allahut në krijimin e bimëve dhe të drurëve me ngjyrë të gjelbër. A nuk është kjo që ka zbuluar shkenca në kohët moderne e njëjta gjë për të cilën tërheq vërejtjen Kur'ani, kur pohon se banorët e Xhenetit gëzohen dhe kënaqen të veshur me të gjelbra të ulur në ndenjëse të gjelbra?

Allahu thotë në Kur'an: ***"Ne do t'ju bëjmë të mundur atyre që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë."*** ("Fusilet", 53)

## Mrekullitë shkencore mjekësore në faljen (namazin) e natës

Në librin e shkruar në gjuhën angleze nga një grup shkrimtarësh, i titulluar "Diagnoza shtëpiake e praktikuar dhe e dobishme dhe fshehtësia e shërimit nga mjekësia popullore" thuhet se ngritja nga shtrati gjatë natës, bërja e disa lëvizjeve të vogla brenda shtëpisë, bërja e disa lëvizjeve të thjeshta gjimnastikore, larja me ujë e disa pjesëve kryesore të trupit dhe marrja frymë thellë ka dobi të mëdha shëndetësore.

Ai që i mendon mirë këto këshilla, sheh se këto përshkruajnë në tërësi lëvizjet e besimtarit kur zgjohet për të falur namaz, duke filluar nga abdesi dhe më pas lëvizjet gjatë kryerjes së namazit të natës. Për të gjitha këto ka folur para katërmbëdhjetë shekujsh Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kur ka treguar vlerat dhe dobitë shëndetësore të namazit të natës e ka thënë: *"Falni namaz nate sepse është traditë e të devotshmëve para jush e afrim tek Allahu për ju, ju ndalon nga mëkatet, jua shlyen mëkatet, si dhe largon sëmundjen nga trupi juaj."*

Mënyra se si namazi largon sëmundjen nga trupi, me lejen e Allahut është vërtetuar si vijon. Është vërtetuar se ngritja dhe falja gjatë natës ndikon në pakësimin e çlirimit të hormonit kurtizol, çka çon në ndalimin e rritjes së sheqerit në gjak. Po ashtu, ndikon në ndalimin e rritjes së shtypjes së gjakut si dhe ndalon koagulimin e gjakut në vena. Rezultati është ngadalësimi i qarkullimit të gjakut gjatë gjumit si dhe trashja e tij për shkak të mosmarrjes së lëngjeve apo për shkak të shëndosjes së tepërt si dhe e vështirëson frymëmarrjen, pengon qarkullimin e gjakut në kokë dhe hollimin e tij. Namazi i natës është, gjithashtu, shërim për pezmatimin e eshtrave, që shkaktohet në nyja për shkak të moslëvizjes së tyre për një kohë

të gjatë kur njeriu fle natën. Ai shërohet me lëvizjet në namaz dhe me larjen e këtyre pjesëve me ujë kur marrim abdes. Namazi i natës ndalon rritjen e tensionit nervor: disa lëvizje të thjeshta gjatë namazit të natës ndikojnë në shërimin e tij. Namazi i natës ndalon rritjen e yndyrërave në gjak, posaçërisht pas ngrënies së tepërt të darkës. Ai pakëson sëmundjen e tingëllimit të veshëve, shkaqet e së cilës janë ende të pazbuluara. Po ashtu, namazi i natës e pakëson rrezikun e ndalimit të zemrës dhe vdekjen e papritur. Namazi i natës aktivizon funksionet e ndryshme të trurit: me këndimin dhe përsëritjen e Kur'anit, me meditimin në ajetet e tij si dhe me kujtimin e duave të ndryshme nga Kur'ani e Syneti.

*"Allahu është Mbrojtësi më i mirë dhe Ai është Mëshiruesi i mëshiruesve!"*

## Sekretet e Kur'anit në psikologji

Në një studim që është bërë në klinikën "Akbar" në Florida, është vërtetuar edhe një herë që, KUR'ANI është fjala e Allahut. Studimi ishte planifikuar të realizohej për ajetet e Kur'anit që flasin për mëshirën dhe kurimin. Ai do të bëhej në lidhje me ndikimin fizik të Kur'anit dhe veçoritë kuruese të tij mbi organizmin. Gjithçka do të vëzhgohej nga mjetet më moderne të kompjuterizuara. Për studim u morën vullnetarisht persona jomyslimanë, që nuk dinin arabisht dhe të moshave të ndryshme. Pra, eksperimenti do të kryhej mbi ata që nuk kishin asnjë njohuri në lidhje me ndikimin kurues të Kur'anit. Së bashku me origjinalin arabisht të Kur'anit, personat dëgjuan edhe përkthimin e tekstit në anglisht. Në këtë kohë, kërkimi i Kur'anit bëhej nga zëra të ndryshëm, duke u marrë kështu parasysh veçoria e ndikimit të zërit. Pas studimeve prej një viti, përfundimi qe i jashtëzakonshëm: në

97% të vullnetarëve të eksperimentuar u vu re një rënie e theksuar e stresit: Kur'ani kishte ndikuar drejtpërdrejt në sistemin nervor. Një arritje tjetër e eksperimentit ishte edhe mundësia e matjes së ndikimit të dëgjimit të Kur'anit mbi trupin e njeriut.

Në këtë sukses, rolin kryesor e luajtën mjetet matëse kompjuterike të prodhuara posaçërisht për këtë eskperiment. Matjet u bënë në saje të ndryshimit të fuqisë elektrike të muskujve, përçimit elektrik të lëkurës, shpejtësisë së rrahjes së zemrës dhe ndryshimit të nxehtësisë së lëkurës. Të gjitha këto ndryshime ndikuan në organet e tjera të trupit dhe në funksionet e tyre, duke bërë të mundur të përcaktohej kështu edhe ndikimi mbi sistemin nervor. Sistemi nervor tregoi, gjithashtu, ndikimin e Kur'anit edhe për vënien në lëvizje të sistemit imunitar, duke bërë të mundur parandalimin e kancerit dhe të shumë sëmundjeve tjera. Përfundimet e pjesës së parë të eksperimentit u paraqitën në "Kongresin e 17-të të mjekësisë islame", në Misuri të Amerikës. Rezultatet u pranuan me entuziazëm.

Kështu doli në pah, krahas burimit kurues shpirtëror, edhe forca shëruese materiale dhe fizike e Kur'anit.

Pra, ata që i kthehen Kur'anit, fitojnë jo vetëm lumturinë e përjetshme, por edhe lumturinë e kësaj bote.

Mjetet që u përdorën për eksperimentin ishin:

Kompjuteri MEDAC 2000 SYSTEM. Ky mjet bënte matjet e ndryshimeve në trupin e njeriut, i prodhuar nga Qendra Mjekësore e Universitetit të Bostonit. Me anë të këtij mjeti vëzhgoheshin drejtpërdrejt matjet fiziologjike të ndikimeve të dëgjimit të Kur'anit mbi trupin e njeriut. MEDAC 2000 SYSTEM, punonte duke qenë i lidhur me disa sisteme të tjera:

Kompjuteri APPLE II, i pajisur me dy disqe regjistruese, videotransmetues dhe printer.

(E.M.G.), që mat përçimin e aktivitetit nervor të muskujve dhe të lëkurës. Matjet përcaktoheshin nëpërmjet elektrodave të vendosura mbi lëkurë. Ky mjet përdoret, gjithashtu, për të matur ngritjen e tensionit të gjakut dhe ndryshime të larta elektrizuese.

Elektrodermal, që mat shpejtësinë e frymëmarrjes dhe kohën e rrahjeve të zemrës. Ky mjet mat edhe ndjeshmërinë e lëkurës. Duke qenë shumë i saktë, arrin të kapë edhe microsiemenset në madhësinë 0.007. Elektrodat matëse të tij janë në madhësinë e majave të gishtërinjëve.

Photo-Electric Plethysm Graphy. Ky aparat mat vazhdimisht shtypjen e gjakut dhe nxehtësinë e lëkurës. Ky mjet, i pajisur me tufa dritash dhe me sisteme kohore, mund të tregojë çdo ndryshim, sado i vogël qoftë, në shpejtësinë e rrahjeve të zemrës dhe në shpejtësinë e lëvizjes së gjakut.

Aparatet, duke mos i lënë vend rastësisë, nxirrnin çdo herë të njëjtin rezultat të ndikimit të Kur'anit tek të eksperimentuarit. Kur dëgjohej fjala "*Allah*", vihej re se rritja e qarkullimit të gjakut, shtimi i rrahjeve të zemrës dhe nxehtësia e lëkurës normalizoheshin.

Vlen për t'u përmendur se dëgjuesit nuk dinin asgjë rreth asaj që dëgjonin. Megjithatë, kur dëgjonin fjalën "*Allah*", ndikimet ishin të menjëhershme, ndryshe prej pjesëve të tjera. Kjo gjendje vërteton në mënyrë të përpiktë ajetin kur'anor:

***"Ne ua dërguam KUR'AN-in njerëzve, për mëshirë dhe shërim."***

Metodat që u përdorën:

Eksperimenti u bë mbi persona të moshave të ndryshme, nga 17-40 vjeç, meshkuj dhe femra. Të gjithë ishin jomyslimanë dhe nuk dinin arabisht. Pjesa e parë e studimit zgjati 42 seanca. Në çdo seancë u zhvilluan pesë eksperimente, d.m.th., numri i të eksperimentuarve ishte

210. Në 85 raste, të eksperimentuarit dëgjuan Kur'an dhe pjesë të tjera, që, nga zëri, toni dhe përbërja e fjalëve, i ngjanin Kur'anit. Këto pjesë u ndërruan pa rregull, d.m.th., përmbajtja e materialeve u mbajt e fshehtë.

Dyzetë prej të eksperimentuarve, nuk iu dha asgjë për të dëgjuar dhe, duke qenë në të njëjtat kushte, iu bënë edhe atyre po ato matje në organizmin e tyre. Por, megjithëse ishin në kushte komode, nuk u pa ndonjë qetësim psikologjik. Kur iu dha atyre të dëgjonin Kur'an, në organizmin e të eksperimentuarve ndodhi mrekullia: ra stresi.

Pas këtij studimi, pritet të bëhen edhe eksperimente të tjera si ky, në lidhje me shërimin e kancerit dhe të shumë sëmundjeve të tjera me anë të Kur'anit.

**Dr. Ibrahim B. Sied**

# Ndikimi i Islamit në mjekësinë botërore

## Mjekësia islame 1000 vjet më parë[1]

**Abstrakt**

*Mjekësia islame është një nga tiparet më të njohura të qytetërimit islam dhe ku myslimanët kanë shkëlqyer më shumë. Sipas fjalëve të Kembellit, "Sistemi mjekësor i Europës është arab, jo vetëm për nga origjina, por edhe për nga struktura. Arabët janë parardhësit intelektualë të europianëve." Myslimanët janë dalluar në* ***bakteriologji****: Al - Raziu bëri përshkrimin e parë mjekësor të lisë dhe të fruthit - dy sëmundje të rëndësishme infektive;* ***anestezi****: Ibn Sina është i pari që futi idenë e përdorimit të anastezikëve nga goja;* ***kirurgji:*** *Al - Raziu konsiderohet si i pari që ka përdorur në kirurgji drenin dhe stomakun e kafshëve për qepje;* ***psikoterapi:*** *në fushën e çrregullimeve psikosomatike, edhe Raziu, edhe Ibn Sina arritën rezultate shumë të mëdha, duke i paraprirë Frojdit dhe Jungut me 1000 vjet;* ***në trajtimin e sëmundjeve të syve****: mjekët islamë kanë qenë të parët në këtë fushë.*

Për më shumë se 1000 vjet, Perandoria Islame vazhdoi të ishte bashkësia më e përparuar dhe më e qytetëruar në botë[2]. Kjo sepse Islami e vuri theksin te rëndësia

1. Botohet me shkurtime. (*redaksia*)
2. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilin M. Hart, dijetar hebre, e rendit të parin në librin e tij, "The 100: The Most Influential Persons in History" (100 njerëzit më me influencë

dhe respekti për dijen, sepse ndaloi shkatërrimin, sepse zhvilloi te myslimani respektin për autoritetin e disiplinën dhe tolerancën për fetë e tjera. Myslimanët e njihnin përsosurinë dhe etjen për dije. Por, nga shekulli X, zelli dhe entuziasmi i tyre për dije bëri që të gjitha shkrimet mjekësore kryesore greke të përktheheshin në arabisht në Damask, Kairo dhe Bagdad. Arabishtja u bë gjuha ndërkombëtare e dijes dhe e diplomacisë. Shekulli i dijes dhe i veprimtarisë shkencore u zhvendos drejt Lindjes dhe Bagdadi u bë kryeqyteti i botës shkencore. Myslimanët u bënë novatorë shkencorë me origjinalitetin dhe prodhimtarinë e tyre.

Mjekësia islame është një nga tiparet më të famshme dhe më të njohura të qytetërimit islam dhe ku myslimanët kanë shkëlqyer më shumë. Myslimanët qenë pishtarëmbajtësit e mëdhenj të kërkimit shkencor ndërkombëtar. Ata e goditën topin e dijes mbi gardhin e Europës. Sipas fjalëve të Kembellit, "Sistemi mjekësor i Europës është arab jo vetëm për nga origjina, por edhe për nga struktura". "Arabët janë parardhësit intelektualë të europianëve".

**Shkollimi mjekësor**: Në vitin 636 të erës sonë, qyteti persian, Xhundi - Shapur, që do të thoshte "kopshti i

në histori), mundi t'i bashkonte fiset arabe, të përçara nga hakmarrjet, rivalitetet dhe luftërat ndërmjet tyre dhe të formonte një bashkësi të fuqishme e të sundonte njëherësh dy perandoritë e njohura të kohës - Perandorinë Persiane dhe Perandorinë Bizantine.
Perandoria Islame shtrihej nga Oqeani Atlantik në Perëndim e deri në kufi me Kinën në Lindje. Vetëm 80 vjet pas ndarjes së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nga kjo jetë, myslimanët kaluan në Europë, për të sunduar Spanjën për më shumë se 700 vjet. Myslimanët i ruajtën kulturat e vendeve të sunduara dhe sollën kulturë e shkencë në to.Sidoqoftë, kur u dobësua Perandoria Islame, pjesa më e madhe e kontributeve islame në kulturë e në shkencë u shkatërrua. Mongolët dogjën Bagdadin (më 1258 të erës sonë) me barbarinë e tyre ; kurse spanjollët, me urrejtjen e tyre shkatërruan pjesën më të madhe të trashëgimisë islame në Spanjë.

bukur", "u pushtua" nga myslimanët me universitetin dhe spitalin e madh. Më pas u ngritën shkollat mjekësore islame sipas modelit Xhundi-Shapur. Shkollimi mjekësor ishte serioz dhe sistematik. Leksionet dhe sesionet klinike mbështeteshin në praktikën. Këshilla që u jepte Ali ibnnul - Abbasi (Ali Abbas: -994,era e jonë) studentëve të mjekësisë është po aq i kohës edhe sot. Për studentin e mjekësisë ishte e detyrueshme të ishte vazhdimisht i pranishëm në spital bashkë me profesorët më të mirë të mjekësisë, të tregonte kujdes të përhershëm për kushtet e të sëmurëve dhe të pyeste vazhdimisht për gjendjen e tyre dhe simptomat e sëmundjeve, duke ruajtur në mendje çfarë kishte lexuar për to dhe çfarë tregonin ato: mirë apo keq. Raziu (841 - 926, era jonë) i këshillonte studentët e mjekësisë, kur vizitonin një të sëmurë, të kishin në mendje simptomat klasike të sëmundjes dhe t'i krahasonin ato me simptomat e gjetura prej tyre.

Mjekët më të zotë, të tillë si, Raziu, Ibn-Sina (Avisena: 980 - 1037, era jonë) dhe Ibn Zuhr (Avenzoar: 1116, era jonë) kryenin edhe detyrën e drejtorit të spitalit edhe të dekanit të shkollave mjekësore. Ata ekzaminonin të sëmurët dhe ua paraqisnin studentëve çfarë ekzaminonin. Anamneza klinike (historiku i sëmundjes) shkruhej dhe ruhej për ta paraqitur në leksion. Në spital mbaheshin regjistra. Në Bagdad, anatomia mësohej duke hapur majmunët, duke studiuar skelete etj. Alkimia ka qenë dikur kërkesë e domosdoshme për t'u pranuar në një shkollë mjekësore. Studimi i bimëve mjekësore dhe shkenca për barnat ishin ndër lëndët e shkollimit bazë. Shumë spitale kishin kopshte bimore si burim për barna për të sëmurë dhe si mjet mësimi për studentët. Shumica e leksioneve mbështeteshin në farmakologji e toksikologji dhe në përdorimin e antidotëve (kundërhelmeve). Gjatë trajnimit klinik, studentët ndaheshin në grupe të vogla

pranë mjekëve të njohur dhe me eksperiencë për vizita në pavijone, diskutime, leksione etj.

Në kurrikula, theksi vihej te qartësia e shkurtësia e përshkrimit të sëmundjes dhe veçimi i një sëmundjeje nga një tjetër.Deri në kohën e Ibn Sinës, përshkrimi i meningjitit ngatërrohej me infeksionin akut që shoqërohej me delir.Ibn Sina i përshkroi simptomat e meningjitit me kaq qartësi dhe saktësi,sa mund të ketë mbetur shumë pak për të shtuar pas 1000 vjetësh. Kirurgjia përfshihej në kurrikula. Pasi mbaronin shkollën, disa studentë specializoheshin nën udhëheqjen e specialistëve të njohur. Disa të tjerë specializohesin qysh gjatë trajnimit klinik. Në shkollë mësoheshin shumë operacione, të tilla si, prerja e një gjymtyre (amputimi), operimi i venave varikoze (variçeve) dhe i hemorroideve. Ortopedia mësohej gjerësisht dhe përdorimi i allçisë në fraktura (thyerje) u tregohej vazhdimisht studentëve. Kjo metodë e trajtimit të frakturave u zbulua në Perëndim më 1852. Trajtimi kirurgjikal i perdes së syrit (kataraktit) ishte shumë i zakonshëm. Obstetrika u qe lënë mamive. Specializantët konsultoheshin me njëri - tjetrin dhe me specialistët. Ibn Sina dhe Haziu, të dy merreshin gjerë me psikoterapinë dhe ua mësonin psikoterapinë studentëve dhe specializantëve. I diplomuari në mjekësi nuk mund ta ushtronte profesionin pa marrë provimin e licensimit. Vetëm në Bagdad, në vitin e parë të urdhrit për licensim, hynë më se 860 veta. Komisionet e licensimit kryesoheshin nga një nëpunës qeveritar, i quajtur mutasib, ose nga një inspektor i përgjithshëm. Mutasibi kontrollonte, gjithashtu, peshat dhe masat e tregtarëve dhe të farmacistëve. Kishte farmacistë që ishin punësuar si inspektorë, për të kontrolluar barnat dhe cilësinë e barnave në një farmaci. Ajo që bën sot *Food and Drug Administration* (*FDA*) (Administrimi i Ushqimeve dhe i Barnave) në Amerikë, është

bërë në mjekësinë islame para 1000 vjetësh. Në qoftë se mjeku i ri kalonte me sukses provimet e licensimit, mutasibi i kërkonte betimin e Hipokratit dhe i lëshonte licensën. Në Perëndim, sidomos në Amerikë, pas 1000 vjetësh është zbatuar licensimi i mjekëve me anë të Komisionit Shtetëror të Licensimit në Mjekësi(*State Licensing Board in Medicine*). Shkollat mjekësore europiane ndoqën modelin e shkollave mjekësore islame.Në fillim të shekullit XIX, studentët e Universitetit të Sorbonës nuk mund të diplomoheshin pa lexuar "Kanunin" e Ibn Sinës.

**Spitalet**: Spitalet u shërbenin qytetarëve falas dhe pa dallim ngjyre, feje, gjinie, moshe, ose gjendjeje shoqërore. Spitalet administroheshin nga qeveria. Drejtorët e spitaleve ishin mjekë. Spitalet kishin pavijone të veçanta për meshkuj dhe për femra. Secili pavijon kishte personelin e infermierëve. Për sëmundje të veçanta (ethe, plagosje, infeksione, mani, ftohje, diare, çrregullime femërore etj.) kishte pavijone të veçanta. Brenda tyre ishte konvalishenca. Kishte ujë pa kufizim dhe banjë për t'u larë. Vetëm mjekët e kualifikuar dhe të licensuar lejoheshin me ligj të ushtronin mjekësinë. Spitalet kishin farmaci që jepnin barna falas për të sëmurët, sallat e tyre të konferencave dhe bibliotekat, me librat më të fundit. Spitali i Tulumit, i ngritur në Kajro më 872 të erës sonë, kishte 100 mijë libra. Universitetet, qytetet dhe spitalet kishin biblioteka të mëdha ; p.sh., Universiteti "Mustansiria" në Bagdad kishte 80 mijë vëllime ; biblioteka e Kordovës, 600 mijë vëllime ; ajo e Kajros 2 milionë dhe ajo e Tripolit 3 milionë. Mjekët kishin koleksionet e tyre të librave, në një kohë kur shtypja e librave nuk njihej dhe libri shkruhej me dorë nga shkrues të zotë dhe të specializuar. Për të parën herë në histori, këto spitale mbajtën të dhëna me shkrim për të sëmurët dhe mjekimin e tyre.

Nga pikëpamja e trajtimit mjekësor, spitali ishte për

të sëmurë të shtruar dhe për të sëmurë ambulatorë. Sistemi spitalor për të sëmurë të shtruar ishte me fare pak dallime, njëlloj si sot. Kur dilte nga spitali, çdo të sëmuri i jepeshin pesë florinj për të mbajtur veten derisa të rifillonte punën.

Spitalet kishin dhoma elegante dhe bibloteka të mëdha. Pavijonet ishin të mëdha, kishin dhoma pritjeje për vizitorët dhe të sëmurët. Në Damask kishte spital të veçantë për lebrozët,kurse në Europë,edhe gjashtë shekuj më pas, me një vendim mbretëror, lebrozët digjeshin. Në burgje bëheshin vizita të rregullta nga mjekët. Në një kohë kur Parisi dhe Londra ishin vende me rrugë me baltë dhe kolibe, Bagdadi, Kajroja dhe Kordova kishin spitale me risi që sot duken, vërtet moderne. Spitalet islame shkëlqyen me humanizmin e tyre, me kujdesin për të sëmurin. Afër pavijoneve të etheve, kishte shatërvanë që freskonin ajrin ; të çmendurit trajtoheshin me butësi e dhembshuri; natën, muzika dhe tregimet qetësonin të sëmurët. Spitalet ishin dy llojesh - të ngulëta dhe të lëvizshme (ambulante). Spitalet ambulante lëviznin me kafshë ngarkese. Ato ishin të pajisur me barna, instrumente, tenda etj. Personeli i mjekëve dhe i infermierëve ishte njëlloj si ai i spitaleve të palëvizshme. Spitalet ambulante u shërbenin invalidëve, atyre që ishin të pamundur dhe atyre që banonin në zona të largëta. Këto spitale përdoreshin, gjithashtu, për të burgosurit, por edhe për publikun e përgjithshëm, sidomos në rast epidemie.

**Bakteriologjia**: Al - Raziu bëri përshkrimin e parë mjekësor të lisë dhe të fruthit - dy sëmundje të rëndësishme infektive. Ai e përshkroi dallimin klinik midis këtyre dy sëmundjeve kaq qartë, sa asgjë tjetër nuk është shtuar më për të që atëherë. Ibn Sina sugjeroi natyrën përhapëse të turbekulozit. Thuhet se ai ka qenë i pari që ka përshkruar mënyrën e përgatitjes së acidit sulfurik

dhe të alkoolit dhe vetitë e tyre. Rekomandimi i tij për verën, si mjekuesi më i mirë i plagëve, ka qenë shumë i përhapur në praktikën mesjetare. Al - Raziu qe i pari që përdori qepjet me mëndafsh dhe alkoolin për ndalimin e gjakrrjedhjes. Ai qe, gjithashtu, i pari që përdori alkoolin si antiseptik (bar që pengon shumimin dhe zhvillimin e mikrobeve).

**Anestezia**: Ibn Sina është i pari që futi idenë e përdorimit të anastezikëve nga goja. Ai njihte opiumin si anestezikun (*mukhadirin*) më të fuqishëm. Anestezikët më pak të fuqishëm ishin mandërgona, lulëkuqja, kuskuta (flokështriga), idhnakthi (beladoni), farat e marules dhe bora ose uji i akulluar. Arabët kanë shpikur sfungjerin gjumësjellës (soporifik) - pararendësi i anastezisë me modem. Ai ishte një sfungjer i njomur me aromatikë dhe narkotikë, që vihej në vrimat e hundës së pacientit. Përdorimi i anestezisë ishte njëri nga faktorët që kirurgjia në botën islame u ngrit deri në nivelin e një specialiteti të nderuar, kur në Europë, kirurgjia nënvleftësohej dhe ushtrohej nga berberë dhe sharlatanë. Më 1163 të erës sonë, *Council of Tours* deklaronte që kirurgjia të braktisej nga shkollat e mjekësisë dhe nga mjekët e ndershëm. Burtoni ka thënë: "Anestezikët janë përdorur në kirurgji për shekuj të tërë në të gjithë Lindjen përpara se në Perëndimin e qytetëruar të bëhej modë eteri dhe kloroformi".

**Kirurgjia:** Al - Raziu konsiderohet si i pari që ka përdorur në kirurgji drerin dhe stomakun e kafshëve për qepje. Ebu - al Kasim, Khalaf ibn Abbas al - Zahraui (930 - 1013, era jonë), i njohur në Perëndim si Abulkasis, Bukasis ose Alzahravius, konsiderohet si kirurgu më me emër në mjekësinë islame. Në librin e tij, "Al - Tasrif", ai përshkroi hemofilinë për të parën herë në historinë e mjekësisë. Libri përshruan dhe ilustron rreth 200 instrumente kirurgjikale, shumë nga të cilat u shpikën

nga vetë Zahraui. Zahraui theksonte në libër rëndësinë e studimit të anatomisë, si një domosdoshmëri themelore për kirurgjinë. Ai mbështeti rimbjelljen e dhëmbit të rënë dhe përdorimin e protezës dentare të gdhendur nga kocka e lopës, që konsiderohet më e mirë se proteza prej druri, të cilën e pati mbajtur presidenti i parë i Amerikës, Xhorxh Uashington shtatë shekuj më vonë. Zahraui është kirurgu i parë në histori që ka përdorur pambukun (në gjuhën angleze *pambuk* është *cotton*- fjalë me prejardhje arabe) në mjekimet kirurgjikale, për të ndaluar hemoragjinë, si mbushje në gështalla, si mbushje vaginale në frakturat e kockave të pelvisit dhe në kirurgjinë e dhëmbëve. Ai futi metodën e heqjes së gurëve në veshka, duke i copëtuar në fshikëzën e urinës.Ai qe i pari që u mësoi të tjerëve pozicionin lithotomik (*lithotomi*= hapje kirugjikale e fshikzës së urinës për heqjen e gurëve që ndodhen në të) për operacionet vaginale. Ai përshkroi trakeotominë (operacion i hapjes së skërfyellit), dalloi strumën nga kanceri i gjëndrës tiroide dhe shpjegoi shpikjen e tij të djegies (kauterizimit) me hekur, të cilën e përdori për të ndaluar edhe gjakrrjedhjen. Përshkrimi i tij për lirimin e variçeve (venave varikoze) është thuajse edhe sot i tillë në kirurgjinë moderne. Në kirurgjinë ortopedike, ai futi atë që sot quhet metoda e Koçerit për uljen e zhvendosjes së kockës së supit dhe prerjen e kockës së kupës së gjurit (patellatomi), 1000 vjet përpara se Bruk ta rifuste atë më 1937. Përshkrimi i Ibn Sinës për trajtimin kirurgjikal të kancerit është i vlefshëm edhe sot pas 1000 vjetësh. Ai thotë se prerja duhet të jetë e gjerë dhe e guximshme ; të gjitha venat që shkojnë tek tumori, duhet të përfshihen në prerje ; në qoftë se kjo nuk është e mjaftueshme, atëherë zona e prekur duhet të digjet (kauterizohet).

Mjekët islamë praktikonin tri tipe kirurgjie: vaskulare (e enëve të gjakut), e përgjithshme dhe ortopedike.

Ata e hapnin me lehtësi barkun (abdomenin) dhe drenonin zgavrën peritoneale (zgavrën e mesit), ashtu si edhe sot. Një kirurgu të panjohur të Shirazit i atribuohet operacioni i kolostomisë (krijim me operacion i një fistule të zorrës së trashë në sipërfaqen e trupit). Absceset e mëlçisë trajtoheshin me punksion (shpim) dhe me eksplorim.

Sot, në të gjithë botën, mjekët zbatojnë disa procedura kirurgjikale që i pati futur në kirurgji Zaharaui 1000 vjet më parë.

**Trajtimi i sëmundjeve të syve**: Mjekët islamë kanë treguar aftësi të shquara në trajtimin e sëmundjeve të syve dhe kanë qenë të parët në këtë fushë. Fjalë të tilla, si *retin*ë dhe *katarakt* janë me prejardhje nga arabishtja. Ibn - al Hajthen (965 - 1039, era jonë), i njohur në Perëndim si Alhazen shkroi "Optical Thesaurus ", nga i cili morën teoritë për shkrimet e tyre të tillë dinjitarë, si Roxher Bejkën, Leonardo da Vinçi dhe Johanes Kepler. Në "Thesaurus-in" e tij ai tregoi se drita bie në retinë në të njëjtën mënyrë, siç bie në një sipërfaqe në një dhomë të errët nëpërmjet një hapjeje të vogël. Kështu, ai provoi se pamja vjen kur rrezet e dritës kalojnë nga objekti te syri dhe jo nga syri tek objekti, siç mendohej nga grekët. Ai paraqiti eksperimente për të provuar këndin e rënies dhe këndin e pasqyrimit dhe një propozim teorik për lentet zmadhuese (që u realizuan në Itali tre shekuj më vonë). Ai na mësoi, gjithashtu, se imazhi në retinë përcillet në tru nëpërmjet nervit optik.

Raziu qe i pari që njohu reagimin e bebes së syrit ndaj dritës, kurse Ibn - Sina qe i pari që përshkroi numrin e saktë të muskujve të jashtëm të kokërdhokut të syrit, domethënë gjashtë.Kontributi më i madh i mjekësisë islame në oftalmologjinë praktike qe për kataraktin (perden e syrit). Arritja më e rëndësishme në heqjen e perdes së syrit erdhi nga Ammar bin Aliu i Mosulit, i cili

e bënte këtë nëpërmjet një gjilpëre të zgavërt metalike përmes cipës së bardheme (sklerës) dhe nxirrte lentet me thithje. Europa e ka rizbuluar këtë në shekullin XIX.

**Mjekimi i sëmundjeve pa ndërhyrje kirurgjikale**: Për këtë mund të thuhen shumë e shumë. Por, për arsye vendi, do të përmendim vetëm disa çështje. Kontributi më i madh u dha nga Raziu, i cili bëri dallimin midis lisë dhe fruthit- dy sëmundje që deri atëherë konsideroheshin si një sëmundje. Në urologji, ai u përqendrua te problemet e urinimit, te sëmundjet veneriane (sëmundje që përhapen nga marrëdhëniet seksuale), infeksionet e veshkave, gurët në veshka dhe fshikzën urinare. Ai përshkroi alergjinë nga lulet. Arabët zbuluan parazitin e zgjebes (nga Ibn Zuhr), bakterin e plasjes (antraksi), parazitin e ankilostomës dhe parazitin e Guinesë (nga Ibn - Sina) dhe sëmundjen e gjumit (që shkaktohet nga pickimi i mizës cece) (nga Kalkashandi). Ata përshkruan abscesin e mesmurores (mediastinit). Ata kuptuan turbekulozin dhe pezmatimin e perikardit (pjesa membranore që rrethon zemrën). Al Hash'ath demonstroi fiziologjinë gastrike 1000 vjet përpara Biemontit. Ebu Shal al-Masihi shpjegoi se përthithja e ushqimit ndodh më shumë nëpërmjet zorrëve sesa nëpërmjet stomakut.Ibn Zuhr futi të ushqyerin artificial me tubin gastrik, ose me klizmën ushqyese. Duke futur tubin në stomak, mjekët arabë bënin lavazhin gastrik (të stomakut) në rast helmimi. Ibn al Nafis qe i pari që zbuloi qarkullimin mushkërior.

Në kryeveprën e tij, "Al - Kuanun", Ibn Sina bëri studime të plota për fiziologjinë, patologjinë dhe higjienën. Ai ka shkruar në mënyrë të veçantë për kancerin e gjirit, helmimet, sëmundjet e lëkurës, tërbimin, pagjumësinë, lindjen e fëmijës dhe përdorimin e pincave obstetrike, meningjitin, humbjen e kujtesës (amnezinë), ulçerat e stomakut, tuberkulozin, prerjen e venës, tumoret, sëmundjet e veshkave etj.

**Farmakologjia**: Metodat e përftimit dhe të përgatitjes së barnave arritën në një shkallë të lartë dhe teknikat e distilimit, kristalizimit, tretjes, kthimit të një substance nga e ngurtë në të avullt, reduktimit dhe kalcifikimit u bënë procese thelbësore të farmacisë dhe të kimisë. Me ndihmën e këtyre teknikave farmacistët futën barna të reja, të tilla si kamfori, sena, sandali, raveni, myshku, mirra, tamarindi (hurmë indiane), arra e hindit, sulfati i aluminit dhe i kaliumit, aloeja, karafili, arra e kokosit, akonita, mërkuri etj. Roli i rëndësishëm i myslimanëve në zhvillimin e farmacisë dhe të kimisë së sotme përkujtohet me numrin e madh të termave të sotëm farmaceutikë dhe kimikë që vijnë nga gjuha arabe: alkaline, alkool, aldehide, elikzir etj., për të mos përmendur shurupet etj. Ata shpikën ekstrakte aromatizuese nga uji i trëndafilit, uji i luleve të portokallit, lëkurat e portokallit dhe të limonit etj. dhe përbërës të tjerë të këndshëm.

**Psikoterapia:** Në fushën e çrregullimeve psikosomatike, edhe Raziu, edhe Ibn Sina arritën rezultate shumë të mëdha, duke i paraprirë Frojdit dhe Jungut me 1000 vjet. Kur Raziu u emërua kryemjek në spitalin e Bagdadit, e bëri atë spitalin e parë që kishte një pavijon vetëm për të sëmurë mendorë.

Arabët nuk i kishin teoritë demonologjike që kishin përfshirë botën e krishtere dhe për këtë arsye, ata ishin të aftë të bënin vrojtime të qarta klinike për të sëmurët mendorë.

Nexhep ud din Muhammed, bashkëkohës i Raziut, ka lënë shumë përshkrime të shkëlqyera për sëmundje të ndryshme mendore. Ai ka përshkruar depresionin, llojet e neurozave obsesive, impotencën seksuale, psikozën persekutuese, dua - kulb-in (një formë manie) etj.

Ibn-Sina njihte psikologjinë fiziologjike për trajtimin e sëmundjeve që kanë të bëjnë me emocionet. Nga

pikëpamja klinike, Ibn Sina krijoi sistemin e ndryshimeve shoqëruese (asociative) te rrahja e pulsit me ndjenjat e brendshme, çka është parë si paraprirëse e shprehjes "testi asociativ" i Jungut.Thuhet se ai ka mjekuar një të sëmurë rëndë, duke i ndier pulsin dhe duke i përmendur me zë të lartë emrat e provincave, rajoneve, qyteteve, rrugëve dhe njerëzve. Duke parë sesi shpejtohej pulsi i pacientit kur përmendeshin emrat, Ibn Sina arriti në përfundimin se i sëmuri kishte rënë në dashuri me një vajzë, vendbanimin e së cilës ai kishte mundur ta lokalizonte me anë të ekzaminimit dixhital. I sëmuri mori këshillën e Ibn Sinës, u martua me vajzën dhe u shërua.

Nuk ka përse të habitemi për të mësuar se në Fez, Marok ishte ngritur një azil për të sëmurët mendorë që në fillim të shekullit VIII; azile për të sëmurë mendorë qenë ndërtuar nga arabët edhe në Bagdad (në vitin 705, era jonë), në Kajro (në vitin në vitin 800), në Damask dhe Aleppo (në vitin 1270). Përveç banjave për t'u larë, barnave, trajtimit mirëdashës dhe të përzemërt, përdoreshin edhe terapia muzikore dhe terapia profesionale. Këto terapi u zhvilluan shumë. Kore dhe banda muzikore silleshin çdo ditë për t'i dëfryer të sëmurët me këngë, shfaqje muzikore dhe shfaqje komike.

E përktheu nga gjuha angleze: **Bledar Shehu**

**Muxhtaba Musavi Lari**

# Pasuria në zemrat e maleve

## Abstrakt

*Allahu e ka krijuar sipërfaqen e maleve që ta përdorte njeriu kur ende s'kishte përparuar shkencërisht. Allahu kishte ruajtur për njerëzit më shumë gurë të çmuar në thellësi të maleve, për t'i përdorur kur të kishte lulëzuar qytetërimi i tyre dhe kur të ishte zhvilluar dija e tyre. Njerëzit i kanë përdorur gurët për themele shtëpish, ose nganjëherë, për çatitë e shtëpive. Vetëm në kohët më të vonshme, njeriu fitoi mjeshtëri dhe zhvilloi mjetet dhe makineritë moderne për të nxjerrë gurë të çmuar nga thellësitë e maleve. Xehet (minierat) janë burime themelore të ardhurash për vende që i kanë këto thesare të çmuara.*

***"A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza".***

Në Kur'an, përshkrimet e makrokozmosit të mahnitshëm që ka krijuar Allahu mund të ndahen në dy.

I pari është shpjegimi i sistemit të ndërlikuar të Krijimit dhe ekzistenca e dukurive frikëndjellëse, mrekullitë e pafund e të cilave njeriu i shikon në tërë hapësirën e gjerë të natyrës. Për ata që besimet vetjake mbështeten në botëkuptimin e qenies së Zotit dhe që e shikojnë unversin si krijesë të mençurisë së përkryer të Krijuesit, çdo moment jep një mundësi për të vëzhguar

një aspekt të ekzistencës dhe për të nxjerrë mësime të rëndësishme nga struktura e saj dhe organizimi i saj. Në këtë mënyrë, ata rrokin lavdinë, shkëlqimin dhe dorën e zgjuar që i ka bërë kaq hijshëm faqet e ekzistencës.

Përshkrimi i dytë është vlerësimi i realiteteve që janë tej botës natyrore, që janë larg nga mekanizmi i ndërlikuar i botës materiale dhe që kanë horizonte të gjera, që nuk u nënshtrohen parimeve kovencionale dhe ligjeve me të cilat ne jemi mësuar. Si rezultat, perceptimi ynë dhe të kuptuarit tonë të aspekteve të fshehta të ekzistencës kufizohet natyrshëm dhe në fakt, dija e njerëzimit është si një pikë e parëndësishme përballë një oqeani të stërmadh, kur është puna për elementet e panjohura dhe sekretet e botës jomateriale.

Komentuesit e Kur'anit e kanë komentuar këtë tip të dytë mrekullie në njëfarë mase, edhe pse, në të vërtetë, asnjë shqyrtim për këto mistere edhe sikur dikush të arrijë ta grisë perden që i mbulon ato, nuk mund të ndriçojë veçse pak më shumë se një pjesëz të ndodhive në botën përtej nesh. Kjo, për arsye se siç ju treguam më sipër, e tërë bota e ekzistencës është shumë më e madhe dhe shumë më e gjerë sesa kjo bota natyrore dhe brenda saj, bota jolëndore është shumë më e pasur dhe shumë më e gjerë se bota lëndore dhe për arsye të kufizimeve të tyre të qenësishme, mjetet shkencore të njerëzimit nuk janë mjaftueshëm të fuqishme për t'i studiuar dhe për t'i analizuar shumicën e këtyre çështjeve.

Sidoqoftë, madje në rastin e veçantë të dukurive që dallohet në botën natyrore, ne mund ta bëjmë kërkimin tonë dhe përpjekjen tonë për t'i përcaktuar faktet në dy mënyra. Njëra mënyrë është t'i komentosh ajetet kur'anore në dritën e dijes moderne dhe t'i analizosh botët e ndryshme natyrore (kafshët, bimësinë, lëndën joorganike etj.) dhe t'i krahasosh zbulimet shkencore

me të dhënat kur'anore, për të demonstruar në mënyrë përfundimtare se nuk ka papajtueshmëri ose kontradiktë midis tyre (midis Kur'anit dhe shkencës) dhe se arsyeja dhe mendja e njeriut e konfirmojnë, gjithashtu, Fjalën e Zotit.

Ne duhet ta mbajmë në mendje se megjithëse dija shkencore jep dritën që ka zgjidhur disa mistere, ajo nuk mund t'i shpërhapë të gjitha sekretet e Krijimit. (Natyrisht, nuk duhet të krahasohet dija që vjen nga Kur'ani me hipoteza shkencore, sepse shkenca mbështetet në eksperimente, kërkime dhe teorema që janë të lëkundshme dhe të pabesueshme dhe gjatë gjithë historisë së saj parimet shkencore i janë nënshtruar ndryshimeve dhe atëherë, nocionet e vjetra bien poshtë. Në të vërtetë, Kur'ani, që do të jetë sa të jetë bota dhe që nuk ka asnjë pasaktësi, duhet të jetë burimi i parë i referimit, me të cilin duhet të gjykohet vlefshmëria e zbulimeve shkencore. )

Së dyti, në lidhje me këto mrekulli të botës natyrore dhe kur studiohen krijime të shumëllojshme që përbëjnë ekzistencën, ne duhet të mbajmë, gjithashtu, në mendje rretanat mbizotëruese kur ka zbritur Kur'ani dhe aftësinë mendore e njerëzve në atë kohë. Ne duhet të marrim parasysh nivelin e aftësisë, të teknologjisë dhe të të kuptuarit e njerëzve që jetonin në atë epokë dhe që nuk i kishin mjetet për të gjurmuar disa nga çështjet e errëta, të paeksploruara dhe të panjohura të Krijimit. Dhe kështu ne arrijmë të kuptojmë mrekullinë që i zbriti Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.)

Dhe në të vërtetë, për ajetin që po shqyrtojmë, përqëndrimi më i madh në hulumtimin tonë është i tipit të dytë, siç do ta shpjegojmë tani.

Xehet (minierat që përmbajnë gurë të çmuar shumëngjyrësh janë burime themelore të ardhurash për

vende që i kanë këto thesare të çmuara. Këto gurë me ngjyra të ndryshme gjenden në thellësi të maleve, në zona të veçanta në të gjithë botën dhe nxirren nga toka me mjete dhe makineri të shumëllojshme dhe procese të stërholluara. Më pas, ato eksportohen në gjithë botën duke u sjellë shumë pasuri dhe vlera vendeve që i prodhojnë ato.

Xehet që përmbajnë gurë të çmuar gjenden dhe shfrytëzohen në shumicën e vendeve. Por, xehet më

të pasura janë në vende të tilla, si Irani, Italia, Kina, Koreja e Jugut, India dhe Portugalia. Ngjyrat kryesore të gurëve janë e bardha, e zeza dhe e kuqja. Ngjyrat e tjera mund të konsiderohen dytësore. Në ajetin që po shqyrtojmë, Kur'ani përshkruan ngjyrat kryesore të gurëve që gjenden në xehe në të gjithë botën; Kur'ani përmend, gjithashtu, ngjyrat dytësore:

"A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza".

Në qoftë se faktet që përmban ajeti i mësipërm nuk paskan ardhur nga Krijuesi i xeheve - Krijuesi i Gjithëfuqishëm, që ka krijuar çdo atom në univers dhe që ka dije të gjithanshme dhe të drejtëpërdrejtë për çdo pjesë të ekzistencës, nga kush tjetër mund të kenë ardhur?

Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e ka kaluar jetën e tij në qytetin e Mekës dhe të Medinës dhe është larguar nga Gadishulli Arabik vetëm në dy udhëtime të shkurtra: njëherë, në fëmijëri, kur e mori i ungji në një karvan në Siri dhe një herë tjetër kur ishte tek të njëzetat, për punë tregtie të Hatixhes - edhe këtë herë në Siri. E, xehet që kanë gurë të çmuar me ngjyra të ndryshme që sot konsiderohen si pjesë e thesarit kombëtar të disa vendeve dhe që u sjellin fitime atyre -

ato gjenden vetëm në një grusht vendesh dhe jo në Siri. Përveç kësaj, ato gjenden në thellësi të maleve. Atëherë, si mundet që Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) të ketë pasur dijeni për ekzistencën dhe natyrën e tyre nga ndonjë burim tjetër informacioni. A do të ishte e mundur që një njeri i zkonshëm, që nuk kishte intuitë a ndonjë lidhje shpirtërore me burimin e gjithë ekzistencës dhe që nuk mund të bënte ndonjë mrekulli, dhe që nuk i kishte ardhur Shpallja, të kishte një dije të tillë në atë kohë? Dhe, fakti që nuk e kishte këtë dije, a nuk është një provë që ai ishte lidhur me Zanafillësin e krijimit dhe që e mori Shpalljen nga Ai ? Në të vërtetë, atëherë, njerëzit, në përgjithësi nuk harxhonin shumë kohë për të vëzhguar misteret e natyrës ose për t'u përpjekur për të zbuluar ato sekrete të panumërta të lëndëve dhe të krijesave të shumëllojshme të botës. Në atë kohë, cili do të ishte ai njeri që do ta kishte këtë dije të qëndrueshme dhe të gjithanshme kur ai nuk e dinde se ekzistojnë xehe, por që fliste për brezat e ardhshëm, të cilët do të nxirrnin gurë të çmuar (që janë numëruar si dhuratë e Zotit bashkë me ujin e shiut) nga thellësitë e maleve?

Ajeti i mësipërm ka natyrë elokuente, që mund të ngjajë së jashtmi me krijime të tjera letrare. Por, ai ka dallueshmëri unike dhe madhështi të pamohushme që e bën atë t'i tejkalojë kufijtë e mendjes njerëzore. Ajeti përmend dy dhënëti të Zotit dhe lidhjen e tyre shumë të ngushtë me jetën e njeriut; njëra është dhënëtia e bimësisë dhe tjetra është dhënëtia e lëndëve joorganike. Bimësia është tërësia e frutave shumëngjyrshe dhe e drithrave, të cilat përmenden në fillim të ajetit dhe që sigurojnë nevojat ushqimore për njeriun dhe forcojnë trupin e tij; dhënëtia e dytë - ajo e maleve - siguron lëndët e para, me të cilat njeriu mund të ndërtojë strehën e tij. Kur'ani i përmend këto dy të mira dhe i tërheq vëmendjen njeriut për këto dy burime të

nevojave të tij më themelore: ushqimin dhe strehimin.

Krijuesi i Urtë e ka krijuar sipërfaqen e maleve që ta përdorte njeriu kur ende s'kishte përparuar shkencërisht; por, Ai i kishte ruajtur për njerëzit më shumë gurë të çmuar në thellësi të maleve për t'i përdorur kur të kishte lulëzuar qytetërimi i tyre dhe të ishte zhvilluar dija e tyre, që t'i shfrytëzonin këto lëndë më të mira për të ndërtuar ndërtesa më moderne. Dhe, siç dihet, në kohët antike, njerëzit nuk kishin mundësi të përdornin (shumë) gurë shumëngjyrësh në ndërtimet e tyre.

Në atë kohë, pjesa më e madhe e gurëve që përdoreshin nga njerëzit ishin me përbërje të varfër dhe zakonisht gjendeshin në të gjitha malet në botë dhe që mund të përdoreshin me lehtësi nga të gjithë. Ata i përdornin gurët për themele shtëpish, ose nganjëherë, për çatitë e shtëpive. Vetëm në kohët më të vonshme njeriu fitoi mjeshtëri dhe zhvilloi mjetet dhe makineritë moderne për të nxjerrë gurë të çmuar nga thellësitë e maleve dhe për t'i përdorur në ndërtime të ndryshme.

Në ajetin e mëposhtëm, Zoti thotë: "Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës".

Përveç ngjyrave të objekteve dhe gurëve brenda maleve në ajet Zoti përmend edhe ngjyrat e ndryshme te njerëzit që janë të bardhë dhe të zinj dhe te kafshët, që kanë aq shumë ngjyra.

Siç e kemi parë, Kur'ani aludon qartë për një shumëllojshmëri të gjerë ngjyrash që gjenden gjithandej te xeherorët, te bimët, te kafshët dhe te njerëzit dhe hap derën për kërkim, kështu që kushdo mund të vëzhgojë natyrën dhe proceset e saj dhe të mrekullohet me sistemin e ndërlikuar që është edhe pas pjesëzës më të vogël të strukturës së pafund të ekzistencës.

Kur'ani shpall se këto mrekulli të Krijimit - secila prej tyre, një shenjë e dijes së pafund dhe madhështisë dhe fuqisë së Zotit të Gjithëfuqishëm - mund të vlerësohet vërtet vetëm nga ata që arsyetojnë ata, mendjet e të cilëve janë ndriçuar nga drita e intuitës, urtësisë dhe vizionit largpamës që e kuptojnë se ndërtimi dhe sistemi gjigand i universit, me gjithë madhështinë e tij është veçse një shfaqje e parëndësishme e fuqisë dhe aftësisë së Tij. Ata e konsiderojnë tërësinë e faqeve të librit të Krijimit një dëshmi të Intelektit Suprem që është pas krijimit të Tij.

Vërtet! Ata që kanë intuitë dhe mendje, kur dëshmojnë projektin mrekullor, qëllimin, programimin dhe urtësinë e pafund mrekullore që e shohin në botë rreth vetes dhe tek trupat qiellorë dhe në zemrën e atomeve dhe të gurëve dhe në çdo aspekt të universit, nga objekti më i vogël deri tek objekti më i madh - ata i tërheq në mënyrë të papërmbajtshme përsosuria e pakufijshme e Krijuesit dhe shpejtojnë vazhdimisht drejt Atij me padurim, me ndezulli dhe me besim të përkryer.

Shpjegimi dhe komentimi i këtij ajeti paraqet një shembull tjetër të mrekullisë së Fjalës së Zotit, e cila nuk është parë nga komentuesit e mëdhenj në veprat e tyre.

Përktheu nga gjuha angleze: **Bledar Shehu**

**Edmir Maxharri**[1]

# Jeta dhe veprat e H. Ali Korçës

## Abstrakt

*Në një hadith të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet: "Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve." Në kohë dhe në vende të ndryshme kanë jetuar dijetarë që janë njohur dhe janë mbajtur mend për dijen e tyre. Edhe në Shqipëri, për shekullin e kaluar, një ndër dijetarët më të mëdhenj dhe të shquar ka qenë H. Ali Korça. Ai ia kushtoi gjithë jetën e tij fesë islame dhe popullit të tij.* ***Veprat e tij të botuara janë:*** *Historia e Shenjtë edhe të Katër Halifetë (1900), Mevludi (1909-1923-1944), Treqind e Tri Fjalët e Imam Aliut (1910), Abetare (1910), Alfabeti arab (1914), Çelësi i Librit Shqip-Arabisht (1916), Gjylistani a trëndafilishta e Sadiut (1918), Myslimania, Bolshevizma a çkaterrimi i njerëzimit (1925), Kur'ani i Madhënueshëm e thelbi i tij (1926) etj.*

Allahu i Madhëruar ka dërguar profetë në çdo popull, me qëllim që t'i udhëzojë njerëzit në rrugën e drejtë. Pas profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!), i cili ishte vula e profetëve, me këtë detyrë u ngarkuan, sipas hadithit të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!): "Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve."

1. Student në universitetin e Uludag në Bursa-Turqi, viti i dytë në do toraturë për Tefsir të Kur'an Kerimit.

Në kohë dhe vende **të** ndryshme kanë jetuar dijetarë q**ë** janë njohur dhe janë mbajtur mend p**ë**r dijen e tyre. Edhe në Shqipëri, për shekullin e kaluar, një ndër dijetarët më të **mëdhenj** dhe të shquar ka qenë H. Ali Korça, q**ë** gjithë jetën e tij ia kushtoi fesë islame dhe popullit t**ë** tij.

Veprimtaria e këtij personaliteti t**ë** shquar duhet treguar brez mbas brezi, me qëllim që të mos harrohet dhe të jetë shembull për ne dhe pasardhësit tanë.

**Jeta e H. Ali Korçës**

**Për Shqipërinë u përpoqa**
**sa flijova jetën time**
**nuk tregohet se sa hoqa**
**se shteti mi njihte krime.**[2]

H. Ali Korça u lind dhe u rrit në një familje intelektuale dhe atdhetare. Babai i tij ishte një nga personalitetet dhe figurat më të njohura të Korçës. Ai lindi, më 5 prill t**ë** vitit 1873 në fshatin Gorricë t**ë** qytetit t**ë** Korçës. Në këtë koh**ë** Korça zinte vend t**ë** rëndësishëm në lëvizjen atdhetare shqiptare. Pikërisht kjo ndikoi edhe në jetën e H. Aliut, i cili u rrit dhe u edukua me frymën dhe ideologjinë e dashurisë dhe të atdhetarizmit.[3]

Mësimet e para i kreu në vendlindjen e tij, ku mbaroi shkollën 8 vjeçare. Në moshën 12 vjeçare mësoi përmendësh Kur'an Kerimin dhe mori gradën "Hafiz". Edhe shkollën e mesme e kreu në vendlindjen e tij, ku gjatë kësaj kohe arriti t**ë** mësonte dhe gjuhën turke. Studimet e larta i ndoqi në Stamboll, vendi ku janë diplomuar dhe shumë intelektualë dhe figura të shquara shqiptare.[4]

2. Ali Korça, "7 ëndrrat e Shqipërisë"
3. Ismail Ahmeti, *Hafiz Ali Korça: Jeta dhe Vepra*, Logos-A, Shkup-2006, f. 25-29.
4. Ismail Ahmeti, *Hafiz Ali Korça: Jeta dhe Vepra*, Logos-A, Shkup-2006, f. 29-30.

Qëndrimi i tij në Stamboll e ndihmoi të arrinte një nivel të lartë arsimi dhe diturie. Kjo periudhë do ishte fillimi i një epoke të re për të, sepse në këtë kohë ai zgjeroi njohuritë e tij në filozofi dhe në letërsi. Gjatë studimeve të larta ai mësoi shumë mirë gjuhën arabe dhe perse, kurse gjuhën franceze e mësoi gjatë studimeve në Korçë, që e ndihmoi të lexonte veprat klasike dhe të shtonte diturinë e tij në këtë fushë.

Gjatë studimeve në Stamboll nuk dihet se nga cilët hoxhallarë apo mësues ka marrë mësim. Në lidhje me këtë gjë, nuk gjendet asnjë informacion, as në librat e tij, as në ndonjë libër tjetër. Por nga shkrimet e tij kuptojmë se cilat kanë qenë veprat që ka lexuar më shumë apo që i ka kushtuar më shumë vëmendje. Në shkrimin e veprave është ndikuar edhe nga dijetarët dhe filozofët, si: Ibn Sina, Ibn Rrushd apo Mevlana dhe nga shkrimtarë, si Omer Khajam apo Shejh Sadi. Por më me shumë respekt dhe nderim përmend Hoxhë Tahsinin, ku thotë se Hoxhë Tahsini ka kontribuuar shumë për arsimin shqiptar. Po ashtu, këtë e përmend edhe në listën e dijetarëve të mëdhenj islamë si, Mollë Fenari, Ebu Suud apo Ibn Kemali.[5]

Gjatë studimeve në Stamboll merr pjesë në lëvizjen atdhetare shqiptare, duke u interesuar për problemet e shqiptarëve, si ato sociale, ashtu edhe politike. Edhe pse ishte larg atdheut, ai i ndiqte zhvillimet dhe përpiqej të ishte sa më afër tyre. Kjo gjë ndodhi edhe për shkak të shoqërisë së tij të re, që krijoi në Stamboll gjatë studimeve. Midis tyre përmendim: Sami dhe Naim Frashërin, madje ka qenë për vizitë edhe në shtëpinë e tyre.

Ndër faktorët që e shtynë dhe e frymëzuan H. Ali Korçën të kishte një përgatitje të lartë arsimore ishte dashuria e madhe që ndiente për atdheun dhe popullin e

5. Ismail Ahmeti, *Hafiz Ali Korça: Jeta dhe Vepra*, Logos-A, Shkup-2006, f. 29-30.

tij. Menjëherë, pas përfundimit të studimeve dhe diplomimit në Stamboll, u kthye në Shqipëri dhe vazhdoi t'i shërbejë vendit dhe popullit të tij me një përkushtim dhe besnikëri të madhe.

Pa kaluar shumë kohë, merr pjesë në Lëvizjen Rilindja Kombëtare dhe, për këtë qëllim, në vitin 1894, me disa anëtarë të lartë të kësaj lëvizjeje, merr rrugën për në Stamboll. Por në Sirkexhi, kur po zbrisnin nga treni, gjatë kontrollit të bagazheve, arrestohet nga policia e Stambollit, sepse në bagazhet e tij gjendeshin disa libra dhe gazeta të padëshirueshme për regjimin e asaj kohe. Për këtë arsye e burgosën në Sinop, ku qëndroi 2 muaj. Pas dy muajsh, me ndërhyrjen e personaliteteve të larta, arriti të lirohet nga burgu dhe të kthehet në Shqipëri.

Pas kësaj ngjarjeje, përpjekja e H. Ali Korçës për popullin e tij do të shtohet edhe më shumë. Menjëherë, sapo kthehet në Shqipëri, bën përpjekje që t'ua mësojë shqiptarëve gjuhën shqipe. Por kur shikon se kjo çështje nuk po zgjidhej me anë të politikës dhe të diplomacisë, atëherë, këtë përpjekje e kthen në luftë. Arrin t'i nxitë shqiptarët të krijojnë çeta të ndryshme. Edhe H. Aliu krijon çetën e tij.

Por Sulltan Abdylhamiti II, edhe pse përdori gjithçka për të kundërshtuar çështjen, edhe pse i përçau dhe i shpërbëhu këto çeta, nuk arriti dot ta ndalonte përpjekjen për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Pavarësisht gjithë këtyre pengesave, H. Ali Korça përsëri nuk hoqi dorë dhe nuk u dorëzua përballë tyre, por, përkundrazi, i vazhdoi përpjekjet e tij për të futur mësimin shqip në shkollat shqiptare.

Këtij qëllimi ia arriti në Kongresin e Dibrës, ku ndikoi në vendimmarrjen e vendimit për arsimimin në gjuhën shqipe. Ky kongres u zhvillua në vitin 1909. Përkrah kësaj H. Aliu hodhi idenë e ndryshimit të alfabetit nga shkronjat osmane në ato latine. Mirëpo kjo gjë

nuk pritet mirë nga Xhon Turqit dhe nga ata shqiptarë që përkrahnin akoma politikën e tyre në Shqipëri. Këta persona, në vitin 1910 zhvilluan një miting, si protestë kundër vendosjes se alfabetit latin.

Po për këtë arsye, disa persona të panjohur, për gjashtë muaj me radhë, e goditën me gur shtëpinë e H. Ali Korçës. Gjendja u keqësua aq shumë, sa u bë e pamundur jetesa brenda saj. Për këtë arsye, H. Aliu i shkroi një letër Valiut të Manastirit, Nuretin Bejit, ku i tregonte për gjendjen e tij: "Nga gurët e vazhdueshëm që janë gjuajtur në shtëpinë time, nuk ka mbetur asnjë tjegull apo xham pa thyer e çdo gjë është shkatërruar. Jetesa në këtë shtëpi është bërë e pamundur, sepse gjithë bora dhe shiu, që bie jashtë, futet brenda shtëpisë."[6]

H. Ali Korça e dinte shumë mirë se kush e kishte bërë këtë gjë dhe se për çfarë arsyesh po ndodhte kjo, sepse ishte shqiptar dhe mbështeste alfabetin latin. Këtë e shpreh dhe në këto vargje:

"Çfarë faji kam unë se Allahu më ka krijuar shqiptar?"

Edhe pse i dërgoi lajm Valiut, përsëri nuk u mor asnjë masë për ndryshimin e situatës. Por, përkundrazi, filluan të thonë: *"Këtij latini, vallë a i gjuajnë me gur shejtanët dhe xhindet!"* Pra, në vend që të merrnin masa, filluan të talleshin me këtë gjendje. Pas ankesave të vazhdueshme, morën masa dhe e ndaluan këtë akt të pahijshëm ndaj H. Ali Korçës dhe familjes së tij.

H. Ali Korça menjëherë, pas kongresit të Dibrës, u zgjodh kryetar i Organizatës për Zhvillim, qëllimi i së cilës ishte përmirësimi i kushteve të jetës së myslimanëve që jetonin në Ballkan. Ky kongres u zhvillua në Elbasan. Kjo organizatë arriti të hapte 34 shkolla fillore dhe 24 shkolla për të rritur, ku mësimi do të zhvillohej në gjuhën shqipe.

6. Ismail Ahmeti, *Hafiz Ali Korça: Jeta dhe Vepra*, Logos-A, Shkup-2006, f. 48-53.

H. Ali Korça ka dhënë mësime të disa lëndëve të ndryshme në shkollën fillore të Korçës, të cilën e themeloi vetë. Në këtë shkollë ka dhënë mësime në lëndën: e matematikës, të gjeografisë, etj.

H. Aliu ka luajtur rol të rëndësishëm dhe në çështjen e pavarësisë së Shqipërisë. Ka bashkëpunuar me figura të njohura për këtë çështje. Një prej tyre është edhe Ismail Qemal Bej Vlora. Po ashtu, ka pasur lidhje të ngushta edhe me qeverisjen e princ Ëilhelm Vidit, të cilin, bashkë me një delegacion, kanë dalë dhe e i kanë uruar mirëseardhjen në Shqipëri. Vetë H. Ali Korça ka përkthyer mes Princ Vidit dhe popullit të vet.

Në vitin 1914 H. Ali Korça u zgjodh drejtor i Ministrisë së Arsimit. Dy vite më pas u emërua Kryemyftiu i Shkodrës. Pas kësaj, në vitin 1918 ai shkoi për të vazhduar punimet e tij në Tiranë. Në Tiranë hapi një medrese me nivel mesatar, ku do të mësohej feja islame. U përkushtua që të fuste një metodë bashkëkohore mësimi në medresetë e Shqipërisë, si dhe të rriste nivelin e studimeve. Gjithashtu, ai u përpoq që t'ua mundësonte studentëve, që diplomohen në këto medrese, të vazhdonin studimet e larta në vendet islame. H. Ali Korça ka punuar në periudha të ndryshme kohe si drejtor shkolle në disa qytete të Shqipërisë, si: në Durrës, në Tiranë, etj.

H. Ali Korça, gjatë jetës së tij, ka dhënë kontribute të mëdha për atdheun dhe popullin e tij dhe shpeshherë këtë e ka bërë duke vënë në rrezik jo vetëm jetën e tij, por edhe të familjes së tij. Gjithashtu, shpeshherë është burgosur apo torturuar për këtë gjë. Po më së shumti, duket se ai do të vuante në kohën e ardhjes në pushtet të regjimit komunist në Shqipëri.

H. Aliu e ka përshkruar rrezikshmërinë e këtij regjimi, 20 vite para se të vinte në pushtet. Këtë e ka treguar në librin e tij "Bolshevizma, shkatërrimi i njerëzisë".

Në lidhje për këtë regjim, ai shprehet në këtë libër:

*"Shih pra nuk mbetën fare ndërtesa*
*Ndër këmbë' u muar e shenjta besa,*
*Xhami e kish s'lan' i rrënuan,*
*E kësi punësh djajtë i shënuan,*
*Priftërinjtë e hoxhë si kec i grinë,*
*Inteligjentët në dhe i shtrinë."*

Në periudhën e ashpër të regjimit komunist H. Ali Korça ka kaluar vite të vështira jetese. Kjo ndodhi për shkak të bindjes së tij fetare dhe punës së tij për përhapjen e fesë islame. Por s'duhet të harrojmë se, në të njëjtën kohë, H. Ali Korça ka dhënë një kontribut të madh edhe për popullin shqiptar, edhe pse kokat e larta të këtij regjimi ia mohuan këto dhe nuk ngurruan ta shpallnin e ta quanin tradhtar të kombit shqiptar.
Këtë gjë H. Aliu e përshkruan në një nga poezitë e tij:

*"Për Shqipërinë u përpoqa*
*sa flijova jetën time*
*nuk tregohet se sa hoqa*
*se shteti m'i njihte krime."*

Në vitin 1947 H. Ali Korça u internua bashkë me familjen e tij në qytetin e Kavajës. Këtu, ai dhe familja e tij, kaluan një jetë tepër të vështirë, edhe vitet e fundit të jetës tij. H. Ali Korça ndërroi jetë me 31 Dhjetor të vitit 1956.

H. Ali Korca ishte një nga personalitet më të shquara që ka njohur Shqipëria gjatë shekullit të kaluar. Gjithashtu, prej tij duhet të marrin shembull të gjithë studentët që studiojnë jashtë apo brenda Shqipërisë, sidomos ata që studiojnë për Teologji islame.

## Veprat e H. Ali Korçës

Krijimtaria e H. Ali Korça përmbledh shkrime nga fusha të ndryshme. Numri i gjithë veprave të tij arrin në 25. Fatkeqësisht vetëm gjysma e tyre kanë arritur të botohen.

Në përmbledhjen e veprave të H. Ali Korçës, që u botua nga shtypshkronja "Logos-A" në Maqedoni, në vitin 2006, janë botuar vetëm ato libra që H. Aliu i kishte botuar kur ishte gjallë. Veprat e pabotuara nuk janë gjetur akoma dhe sot. Cekëm më lart se H. Ali Korça dhe familja e tij u internua nga regjimi komunist. Familja e tij, kur mori vesh se shërbimet sekrete të regjimit komunist do të vinin për kontroll në shtëpinë e tyre, u detyrua që një pjesë të librave t'i djegin dhe një pjesë ta groposnin. Këtë e bënë nga frika se mos i vrasin apo i keqtrajtojnë. Familja e tij nuk i zotëron më këto libra.

Edhe pse ekziston mundësia se dikush tjetër mund t'i zotërojë këto vepra, përsëri deri më sot nuk ka dalë asnjë që t'i shfaqë ato apo të thotë ndonjë gjë në lidhje me këtë. Ashtu siç e përmendëm më lart, veprat e lëna jashtë përmbledhjes së veprave të botuara nga shtypshkronja "Logos-A", nuk janë botuar as kur shkrimtari ishte gjallë. Mund të kenë qenë arsye ekonomike ato që e kanë shtyrë H. Ali Korçën të mos i botonte veprat e tij.

Përmbledhja e veprave të botuara përfshin 12 libra. Libri i parë i serisë së librave është i Ismail Ahmetit, që flet për jetën dhe veprën e H. Ali Korçës. 11 librat e tjerë janë të gjitha veprat e H. Ali Korçës.

Gjithashtu, duhet theksuar se shkrimet e tij, H. Ali Korça i ka botuar pjesë - pjesë në gazeta dhe revista të ndryshme të kohës, si: "Zani i Naltë". Librat e botuar sot janë marrë nga këto gazeta dhe revista.

Krijimtaria e H. Ali Korçës në këtë shkrim do të paraqitet duke e ndarë në dy grupe. Në grupin e parë do

paraqiten veprat e botuara të tij, kurse në grupin e dytë veprat e pabotuara.

Veprat e H. Ali Korçës janë të fushave të ndryshme: poezi, histori, tefsir, etj.
Tani le t'u hedhim një sy atyre.

## a) **Veprat e botuara**

❖ *Historia e Shenjtë edhe të Katër Halifetë* (1900)[7]

Është vepra më voluminoze e H. Ali Korçës. Në këtë libër, autori tregon historinë e profetëve, duke filluar me profetin e parë, Ademin deri te Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!). Radhitja e profetëve sipas H. Ali Korçës është: Ademi, Shiti, Idrizi, Nuhu, Hudi, Salihu, Ibrahimi, Luti, Ismaili, Is'haku, Jusufi, Musai, Jusha, Davuti, Lokmani, Sulejmani, Iljazi, Junusi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të gjithë!). Gjithashtu, këtu ka treguar edhe historinë e disa profetëve, që nuk përmenden në Kur'an, si dhe ka përmendur historinë e Merjemes, profetit Isa dhe në fund ka treguar jetën e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) deri në ngjarjen e miraxhit, të cilën e ka shpjeguar në formë poezish. Gjatë shpjegimit të jetës së Isait (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) është ndalur dhe tek besimi i trinitetit, ku ka bërë një kritikë për këtë besim. Këtu ka shpjeguar formën e besimit të trinitetit në fe dhe kultura të ndryshme, si për shembull, tregon shkurtimisht besimin e trinitetit tek popujt dhe fetë, si: Hinduizmi, Budizmi, Egjipti i vjetër, Irani i vjetër, etj.[8]

